

LËVIZJA
KOMBËTARE
DHE
UNGJILLI



XHEJMS KLARK

Autori: Xhejms Klark (James Clarke)
Ekipi i Redaktimit: Agesil Qiriazhi / Laura Clarke
Këshilltar për çështjet historike: David Hosaflook
Botoi: AEM-Misioni Ungjillor

E drejta e autorit në gjuhën shqipe: © AEM-Misioni Ungjillor

Të drejtat e rezervuara: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi. Email, office@aemission.al

Citimet janë marrë nga Bibla Diodati i Ri (1991-1994) përveç në pasthënie. Citimet biblike në Pasthënie janë marrë nga Dhjata e Re, Versioni ABS (2002).

E drejta e autorit © Shoqëria Biblike Shqiptare A.B.S (Tiranë).



Shtypur: Vernon Publishing SH.P.K
Tiranë, Tetor 2017
Tirazhi: 6000 kopje

*Nuk kam turp për ungjillin e
Krishtit, sepse ai është fuqia e Perëndisë
për shpëtimin e cilitdo që beson...*

ROMAKËVE 1:16

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Vështrim Historik	9
Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja	14
Aleksandër Tomsoni dhe librashitësit shëtitës	20
Gjerasim Qiriaz	24
Sevasti Qiriaz-Dako	30
Gjergj Qiriaz	34
Grigor Cilka	36
Thanas Sina	39
Fineas dhe Violet Kenedi	40
Çarls Telford Eriksoni	42
Pasthënie - Çfarë është ungjilli?	47
Një tregim i shkurtër i atyre gjërave që na mëson Shkrimi i Shenjtë	47
Lexime të mëtejshme	55
Shënime	56



1) Gjergj Fishta

5) Ndre Mjeda

9) Sotir Peci

2) Mit'hat Frashëri

6) Grigor Cilka

10) Bajo Topulli

3) Luigj Gurakuqi

7) Taçi Buda

11) Nyshet Vrioni

4. Gjergj Qiriaz

8)Shahin Kolonja

Gjergj Qiriaz dhe **Grigor Cilka** ishin besimtarë ungjillorë shqiptarë në Komisionin e Kongresit të Alfabetit.

HYRJE



ISMAIL QEMALI

Gjashtë muaj pasi shqiponja dykrenore u ngrit më 28 nëntor 1912 në një ballkon në Vlorë, Ismail Qemali ishte në Londër për Konferencën e Ambasadorëve. Në kohën kur ishte atje, ai shkoi për vizitë te disa të krishterë ungjillorë anglezë që “t’i falënderonte për gjithë ndihmën që i kishin dhënë çështjes shqiptare...”¹ Ata ishin anëtarë të Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (The British and Foreign Bible Society). Më 1912-n Mit’hat Frashëri dëshmonte gjithashtu se Shoqëria Biblike ishte bërë “e nderuar dhe e lavdëruar pothuajse nga të gjithë shqiptarët patriotë, qofshin myslimanë apo të krishterë.”² Po cilët ishin këta njerëz dhe çfarë kishin bërë ata për Shqipërinë, që të meritonin lavdërimi të tilla?

Pesë vjet më parë kishte ndodhur një nga ngjarjet më domethënëse në historinë shqiptare: Kongresi i Manastirit (1908). Por ajo që shumë njerëz ndoshta nuk e dinë, është që disa prej pjesëmarrësve më të rëndësishëm atje ishin besimtarë ungjillorë shqiptarë, si Gjergj Qiriazi, nënkryetari i Klubit “Bashkimi” në Manastir dhe pastori ungjillor Grigor Cilka. (Të dy shihen në foton në faqen 6)

Edhe para vitit 1908, kishte të krishterë ungjillorë të tjerë, si Gjerasim Qiriazi (vëllai i madh i Gjergjit), besimi dhe patriotizmi i të cilit u kombinuan për ta bërë një figurë me ndikim të madh në rizgjimën kombëtar shqiptar.

Ndonëse nuk është një fakt mjaft i njohur, të krishterët ungjillorë dhanë një kontribut jetësor për pavarësinë e Shqipërisë dhe ishin në zemër të lëvizjes patriotike për gjuhën shqipe.

Për fat të keq, ky kontribut u mohua gjatë komunizmit në Shqipëri, madje, edhe sot, shumë njerëz janë të painformuar për rolin që kanë luajtur ungjillorët në historinë shqiptare. Shumë supozojnë në mënyrë të gabuar se ungjillorët erdhën për herë të parë në Shqipëri pas viteve 1990. Më në fund, në vitin 2011, komuniteti ungjillor përsëri u njoh zyrtarisht si një prej pesë komuniteteve fetare tradicionale të Shqipërisë.

Mjaft studiues shqiptarë dinë për historinë e ungjillorëve në Shqipëri para Luftës së Dytë Botërore dhe kanë shkruar për ta, siç është gjuhëtari prof.dr. Xhevat Lloshi, por mes shqiptarëve sot, shumë njerëz nuk janë akoma në dijeni të kësaj historie të fshehur.

Ky libër tregon se si ungjilli dhe Bibla kanë qenë të ndërthurur me historinë e popullit shqiptar dhe flet gjithashtu për rolin që të krishterët ungjillorë shqiptarë dhe të huaj kanë luajtur në zgjimin kombëtar të Shqipërisë. Për të kuptuar arsyen se përse ka ndodhur kjo, duhet kuptuar se çfarë është ungjilli. Prandaj, në fund do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të kuptimit të tij nga atdhetari i shquar ungjillor Gjergj Qiriazi.

* * *

VËSHTRIM HISTORIK

“Prej Jeruzalemit e përqark dhe gjer në Iliri, kam kryer shërbimin e ungjillit të Krishtit.”

- Apostulli Pal, duke shkruar në vitin 57 pas K., Romakëve 15:19

Të krishterët ungjillorë e marrin emrin e tyre nga ungjilli i Krishtit (ευαγγέλιον në greqishten e Dhiatës së Re). Termi “ungjillor” u përdor nga të krishterët protestantë për të theksuar faktin se besimi i tyre

nuk bazohej në traditat apo organizatat njerëzore, por në të vërtetën e ungjillit, i cili është mesazhi i shpëtimit në Bibël. Ashtu si apostulli Pal, ungjillorët besojnë dhe predikojnë ungjillin e Krishtit.

Ungjilli në Antikitët

Ungjilli, në asnjë mënyrë, nuk është diçka e re për shqiptarët. Është një fakt i mirënjohur historik që një nga vendet e para që dëgjoji ungjillin e Krishtit ishin viset që sot i njohim si Shqipëri. Ata paraardhës të hershëm të Shqipërisë që dëgjuan ungjillin dhe e vunë besimin e tyre te Jezu Krishti, bënë kështu në të njëjtën kohë siç bënë edhe banorët e Jeruzalemit, Romës, Athinës, dhe kjo përpara shumicës së botës. Historiani Daniele Farlati regjistron se, që nga viti 58 pas Krishtit, kishte një grup të konsiderueshëm besimtarësh në Durrës.³

Ungjilli në Mesjetë


Edhe në epokën e Mesjetës, ungjilli ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë, nëpërmjet klerikëve. Shumë prej dokumenteve më të vjetra të shkruara në shqip lidhen me të. Për shembull përmbajtja kryesore e Mesharit të Gjon Buzukut (1555) janë citime nga Bibla. Veprat e Pjetër Budit gjithashtu përmbajnë shumë citime prej Biblës. Ndërsa titulli i plotë i veprës së Pjetër Bogdanit *Çeta e Profetëve*, në fakt është: *Çeta e profetëve përsa i përket Krishtit, Shpëtimtarit të Botës dhe e Vërteta e tij e Ungjillit*.

“Unë, Don Gjoni, biri i Benedikt Buzukut, duke u kujtuar shumë herë se gjuha jonë nuk kishte gjë të kuptueshme nga Shkrimi i Shenjtë, për të dashurit e botës sonë, desha me u përpjek, për sa munda me ditë, për të ndriçuar pak mendjet e atyre që të kuptojnë, për sa ata të mund të marrin se sa i lartë dhe i fuqishëm dhe i përmëshirshëm është Zoti ynë ndaj atyre që e duan atë me gjithë zemër.”

Transliterim i origjinalit: “U Donih Gjoni, biri hi Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonëh nukë kish gjaa të endigluom ensëh shkruomit shenjtë, ensëh dashunit sëh botësë sanëh, desha me u fëdigunëh për saa mujtah meh ditunëh, meh zditunë pak mendetë e atyneh qi t’eh endiglonjinëh, për seh ata tëh mundëh mernëh saa hi naltë e hi mujtunë e hi përmishëriershim anshtë Zotynë atyneh qi tah duonë em gjithëh zemërë.”

Lëvizja Protestante

Në fund të periudhës mesjetare, Bibla u bë frymëzimi i një lëvizjeje në Europë, të cilën ne sot e njohim si “Reformimi Protestant”. Kur klerikët, si Xhon Uiklifi (John Wycliffe) në Angli dhe Jan Husi në Bohemi lexuan Biblën, u gëzuan dhe u frymëzuan me mesazhin e Ungjillit që gjetën aty. Ndërkohë, u bindën që Kisha Katolike kishte devijuar prej Biblës në shumë aspekte. Hierarkia e Kishës zyrtare nuk iu bind kritikave dhe thirrjeve për reforma, por përkundrazi, përdori autoritetin e saj për t’i heshtur këto. Xhon Uiklifi u shkishërua dhe Jan Husi u ekzekutua. Mirëpo, idetë e tyre nuk do zhdukeshin aq kollaj.



MARTIN LUTERI

Zakonisht, fillimi i Lëvizjes Protestante konsiderohet 31 tetori i vitit 1517, kur profesori i Universitetit të Vitenbergut, kleriku Martin Luter (Martin Luther), u përpoq të hapte një debat teologjik për abuzimin e shitjeve të indulgjencave (faljeve ose ndjesave). Reagimi i Kishës ishte që Luteri duhej të tërhiqte dhe të pranonte autoritetin e papës mbi këtë çështje, por Luteri ishte i bindur nga leximi i tij i Biblës, që kishte të drejtë. Kjo ngjarje nënvizoi një pyetje të pashmangshme: “Cili është autoriteti përfundimtar në çështjet e besimit? A ishte papa, këshillat zyrtarë të kishës apo vetë Bibla?” Luteri (si Xhon Uiklifi dhe

Jan Husi para atij) u bind se Bibla ishte autoriteti përfundimtar dhe i vetmi autoritet i pagabueshëm për çështjet e besimit. Bibla ishte Fjala e Perëndisë.

Në të njëjtën kohë, në Zvicër po ndodhte një lëvizje shumë e ngjashme dhe kleriku Ulrich Cvingli (Ulrich Zwingli) kishte dalë në të njëjtin përfundim. Idetë e Luterit dhe të Cvinglit u përhapën në Europë, dhe kjo çoi në formimin e kishave të pavarura nga Kisha Katolike e Romës. Zhan Kalvini (Jean Calvin), gjithashtu, u bë një nga aktorët kryesorë në këtë Lëvizje. Është me rëndësi të theksohet që protestantët nuk kishin aspak si qëllim të formonin një “fe” të re, por, përkundrazi, synonin një kthim te besimi i krishterë origjinal, që gjendet në Bibël.

Protestantët donin ta transmetonin lajmin e mirë të ungjillit te populli gjerësisht, por gjuha e Kishës deri atëherë ishte latinishtja, të cilën shumica nuk e kuptonin. Protestantët vendosën që ta çlironin Biblën nga gjuha zyrtare e Kishës. Sipas bindjes së tyre, Bibla nuk duhej të ishte e kufizuar vetëm në gjuhën e arsimit të lartë, por duhej të ishte në gjuhën amtare të çdo njeriu, në gjuhën e popullit. Me shpikjen e shtypshkronjës, Biblat u botuan në anglisht, gjermanisht, çekisht, italisht etj. Këto përkthime të Biblës kontribuan në historinë e shumë shteteve të Europës dhe sollën mesazhin e ungjillit te milliona njerëz. Nga ana kulturore dhe fetare, Bibla ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në historinë mbarëbotërore të njerëzimit, duke përfshirë edhe popullin shqiptar.

Ungjilli dhe Rilindja Kombëtare

Gjatë Rilindjes Shqiptare, Bibla pati një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm. Në këtë kohë, u bë i dukshëm fakti se të paturit e një forme të shkruar të gjuhës shqipe ishte jetësore për shpëtimin e identitetit shqiptar nga shkrirja me pushtuesit ose fqinjët e vet. Vendosja e alfabetit standard të shqipes u konsiderua si hap i domosdoshëm drejt

“...e par’ e punëvet, që duhetë të këtë kujdes një komb, që do të ruanjë kombërin’ e ti, është të shkruarët’ e gjuhës së ti...”

Sami Frashëri,
Shqipëria ç’ka qënë ç’është e ç’do të bëhetë, Bukuresht, 1899.
(Ribotim: Tiranë, 1962, fq. 54.)

autonomisë dhe
pavarësisë. Sami

Frashëri shkroi: "...Ajo
q'ë bën të nëmërohetë
një komb më vetëhë,
është gjuhë... Një
gjuhë, që s'shkruhet' e
s'këndohetë nukë ziretë
gjuhë... P'andaj e par'
e punëvet, që duhetë
të këtë kujdes një
komb, që do të ruanjë
kombërin' e ti, është të



PERANDORIA OSMANE, 1801

shkruarët' e gjuhës së ti..."⁴ Në fakt, ishte bindja e Mihal Gramenos se në Kongresin e Berlinit (1878), ndërsa Serbia, Mali i Zi dhe Rumania fituan njohjen si shtete të pavarura, apelimi i shqiptarëve për autonomi, prej Lidhjes së Prizrenit, u refuzua me justifikimin se "Komb pa gjuhë të shkruar nuk ka!"⁵ Pranimi i autonomisë apo i pavarësisë së Shqipërisë varej nga arritja e një forme standarde të shkruar të gjuhës së saj unike. Por kjo nuk do të ishte e lehtë të realizohej. Si autoritetet osmane, ashtu edhe ato greke i shtypnin përpjekjet për të përhapur një shqipe të shkruar.⁶

Pikërisht në këtë moment kritik, ungjilli, nëpërmjet besimtarëve ungjillorë, dha kontributin e tij më të rëndësishëm në pavarësinë e Shqipërisë. Për shumë vite, në disa nga trojet shqiptare, librat biblikë dhe gramatikat e botuara dhe të shpërndara nga ungjillorët, ishin të vetmit libra në qarkullim në gjuhën shqipe.⁷

Xhon Kuanrudi (John Quanrud) shpjegon në librin e tij *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*: "Autoritetet osmane u ndodhën përballë një sfide të papritur. Si pasojë e politikës së tyre armiqësore ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare dhe idealeve të saj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp dhe udhëheqësit e saj u burgosën e u syrgjynosën. Krahinat shqiptare ndodheshin nën një sundim pothuajse ushtarak, ku autoritetet vendase rrinin në gatishmëri për të shtypur çdo veprimtari "subversive". Megjithkëtë lëvizja kishte fituar një përkrahës të ri..."⁸

Kuanrudi vijon të shpjegojë se, në këtë moment, shpërndarja e ungjillit në Shqipëri, si dhe e librave të gramatikës shqipe të botuara nga ungjillorët “nxiste shtrirjen dhe përdorimin e shqipes si gjuhë e shkruar, duke bartur kështu me vete një mundësi të madhe për bashkimin e shqiptarëve.”⁹ Përhapja e gjuhës shqipe të shkruar nisi një “efekt domino” që çoi drejt unifikimit të alfabetit, njohjes më të gjerë të shqiptarëve si komb unik dhe, si rrjedhim, drejt shpalljes së pavarësisë në vitin 1912.

SHOQËRIA BIBLIKE BRITANIKE DHE PËR VENDET E HUAJA

KONTRIBUTI KRYESOR:

*Mbështetja e gjuhës së shkruar shqipe
Botimi i Biblës për herë të parë në gjuhën shqipe
(në toskërisht dhe në gegënisht)*

Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (SHBBVH), një organizatë e themeluar në vitin 1804, kishte si qëllim kryesor ta bënte ungjillin të disponueshëm për të gjithë njerëzit në gjuhën e tyre amtare, që ata të mund të njihnin Krishtin. Në shumë vende të botës, aty ku gjuha kishte vetëm formën e folur, ata kanë ndihmuar për të krijuar dhe përhapur një formë të shkruar të gjuhës, në të cilën

Bibla të mund të përkthehej dhe të botohej për përfitimin shpirtëror të vendasve. Shpesh kjo kërkonte sakrificë të madhe personale të punëtorëve të shoqërisë.

Më 28 gusht 1816, Rev. R. Pinkerton (një përfaqësues i Shoqërisë) i shkroi SHBBVH-së: “Pajisja e shqiptarëve, të paktën me Dhiatën e Re në gjuhën e tyre, është një objekt që e meriton në shkallën më të lartë të tërheqje vëmendjen e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Ata nuk kanë ende asnjë pjesë të Fjalës së Perëndisë në gjuhën e tyre...pajisja e shqiptarëve me Dhiatën e Re në gjuhën e tyre me siguri do të ishte një objekt që do të meritonte përpjekjet më

“Nderim të drejtë mirënjohjeje për Shoqërinë Biblike... për shërbimet që ajo i ka bërë vendit dhe letërsisë sonë nëpërmjet përkthimit të Shkrimve të Shenjta në gjuhë shqipe. Në të vërtetë, është e pamundur të flitet për gjuhën dhe letërsinë e Shqipërisë pa sjellë ndërmend mundimet dhe përkushtimin e atyre, që, për aq gjatë dhe përballë shumë vështirësive, e kryen këtë punë.”


- Mit'hat Frashëri
Shqiptarët, Kartë e Pendë, fq. 321

të para dhe më të zellshme.”. Më 25 tetor 1819, ai shkroi përsëri: “Një përkthim i Dhiatës së Re në gjuhën shqipe më është lidhur në zemër në këta disa vjet të shkuar aq fort, sa me të vërtetë nuk mund të shpëtoja prej tij...”¹⁰

Përkthimi i parë.

Në këtë kohë, “letërsia në gjuhën shqipe pothuajse nuk ekzistonte fare, duke qenë se ishte e ndaluar... nga autoritetet shtetërore turke...”¹¹

Gjithashtu, nuk ekzistonte një alfabet standard i shqipes. Pavarësisht këtyre pengesave të mëdha, Shoqëria vendosi të përkthente ungjillin në shqip. Në vitin 1819, Pinkertoni shkoi për t’u konsultuar me Vangjel Meksin në Stamboll, i cili i ishte rekomanduar Pinkertonit si një përkthyes i mundshëm. Vangjel Meksi ishte një shqiptar i mirarsimuar, me origjinë nga Labova, Gjirokastrë. U lind në vitin 1770. Pas studimeve në Janinë, u bë mjek në oborrin e Ali Pashës deri në vitin 1810. Me sa duket, rreth kësaj kohe Meksi filloi të zhvillonte një interes në krijimin e një gjuhe shqipe të shkruar. Thuhet se ai shkroi një gramatikë të shqipes.¹²



UNGJILLI SIPAS MATEUT, 1824

Çështja kryesore ishte se cilat shkronja duhet të përdoreshin për ungjillin. Në fund u zgjodhën shkronjat greke, me disa modifikime, për këtë përkthim të parë. Edhe pse kjo nuk do të ishte një zgjedhje e përsosur, të paktën ata shqiptarë që dinin greqisht, do të ishin menjëherë në gjendje të lexonin dhe të kuptonin ungjillin në shqip dhe t’u lexonin të tjerëve që nuk dinin greqisht. Kishte shkolla që mësonin

greqisht dhe gjithashtu ekzistonte pak letërsi në këtë formë.¹³ Pas këtij diskutimi, Shoqëria Biblike vendosi ta punësojë Meksin për të përkthyer Dhiatën e Re në shqip. Meksi e përfundoi punën brenda dy vjetëve, dhjetë muaj para afatit të kontratës.¹⁴ Pasi e kishte përfunduar përkthimin, shpërtheu kryengritja greke për pavarësi dhe Meksi iu bashkua forcave greke për të punuar si mjek. Kështu kontribuoi në rrëzimin e sundimit osman. Ai vuajti disa herë nga pneumonia dhe vdiq shpejt pas kësaj.


Shoqëria Biblike e vuri redaktimin e përkthimit nën kujdesjen e peshkopit ortodoks Grigor Gjirakastri. Në vitin 1824, Ungjilli sipas Mateut u botua si provë.¹⁵ Ishte hera e parë që botohej një ungjill i plotë në gjuhën shqipe. Kur kjo u mirëprit me aprovim dhe gëzim të madh ndër shqiptarët, nisi redaktimi dhe botimi i gjithë Dhiatës së Re, i cili doli nga shtypi në vitin 1827. Kjo është Dhiata e Re e parë në gjuhën shqipe.

Për shkak se ky përkthim ishte shkruar me shkronja greke, përdorimi i tij ishte i kufizuar, sidomos në veri të Shqipërisë. Pavarësisht kësaj, kjo duhet të njihet si një hap i madh në themelimin e gjuhës shqipe, si dhe në prurjen e Biblës te shqiptarët, në gjuhën e tyre amtare. Xhevat Lloshi shkruan: “Kjo ishte një ngjarje kulturore me aq rëndësi për gjuhën shqipe, sa ka rrezatuar gjatë gjithë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Me këtë botim të Shoqërisë Biblike, gjuha jonë doli në një pikë të rrafshit botëror të letrës së shtypur, zuri vend në një hartë ku nuk ekzistonte më parë.”¹⁶

Përkthimi i dytë

Rreth 35 vjet më vonë, Shoqëria Biblike punësoi Konstandin Kristoforidhin për të bërë përkthime të ungjillit, të cilat do të bëheshin jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e një gjuhe standarde të shkruar.

I mirënjohur dhe mjaft i dashur prej shqiptarëve edhe sot, Kristoforidhi lindi rreth vitit 1830, biri i një argjendpunuesi në Elbasan. Ai u dallua që nga fëmijëria, për dëshirën e tij të pashuar për studim. Shkoi në gjimnazin “Zosimea” në Janinë, një nga shkollat më të mira të



SHKOLLA ZOSIMEA (JANINË)

Ballkanit në atë kohë, ku ndihmoi gjithashtu albanologun e madh gjerman Johan Giorg fon Han, për të mësuar shqip, duke përdorur si tekst pikërisht Dhiatën e Re të Shoqërisë Biblike, të vitit 1827.¹⁷

Mendohet se për një farë kohe Kristoforidhi punoi në Tiranë si mësues dhe pastaj në tregti, por kjo pjesë e jetës së tij ende nuk është e zbardhur plotësisht. Duke udhëtuar nëpër qytete të ndryshme, si Tirana, Elbasani dhe Berati, kjo përvojë duhet të ketë kontribuar shumë në formimin e njohurisë së tij të dialekteve të krahinave shqiptare. Ka gjasa që, qysh atëherë, filloi të mblidhte fjalë, fraza e shprehje, të cilat më vonë do t'i shërbenin

DIATA E RË

E ZOTIT EAE SHËLBËESIT T'UNË

IESU-KRIŠTIT,

KËQJEM PREI GREKËSITESË VIETËR

Š KIP

NDË GUHË GEGËNISTE

prei


KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT.

KONSTANTINOPOL.

Šitunq ndq Stambol, uđa Fildandzilër-Yokuša,
ndq Magazinq tđ Biblësq.

Nđq štupa-škronq tđ A. H. Boyađianit.
1872.

DHIATA E RE GEGËRISHT, 1872



K. KRISTOFORIDHI

si përkthyes dhe do të hynin në Fjalorin Shqip të tij, botuar në vitin 1904, pas vdekjes.

Në vitin 1857 e gjejmë Kristoforidhin në qytetin e Izmirit, ku u anëtarësua në një kishë protestante.¹⁸ Tashmë ai kishte filluar të përkthente pjesë të Biblës. Më 1857 misionarët ungjillorë në Izmir e lidhën Kristoforidhin me misionarët e Stambollit, aty ku filloi studimet në Seminarin e Bebekut dhe pastaj shkoi në Maltë, ku studioi për tre vjet në Kolegjin Protestant të Maltës.

Pas një kohe duke jetuar në Tunis si mësues, Kristoforidhi mori ftesën e Shoqërisë Biblike për të punuar si përkthyes i Biblës.¹⁹ Ai pranoi. Kësaj radhe botimet e përkthimit nuk do të ishin vetëm me shkronja greke, por edhe me ato latine dhe, në mënyrë të jashtëzakonshme, në të dy dialektet, toskë dhe gegë! Këtë punë të pamasë ai e kreu në mënyrë shumë të ndërgjegjshme. Përktheu me këmbëngulje të pazakontë fillimisht katër ungjijtë dhe pastaj pjesë të tjera të Biblës.

Në vitet 1870, Kristoforidhi punoi për një farë kohe me Shoqërinë Biblike në viset shqiptare, si librashitës shëtitës (shih më poshtë), duke shpërndarë përkthimet e tij të Shkrimeve të Shenjta dhe duke këmbëngulur te njerëzit për nevojën e studimit të shkrimeve në gjuhën e tyre.²⁰ Në vitin 1872, ai shpërndau mbi 1000 kopje dhe në vitin 1874 mbi 1100! Në Berat Kristoforidhi takoi një mësuese, e cila kishte mësuar nxënësit e saj të lexonin shqip. Aty që të gjitha shkollat morën kopje të përkthimit të Kristoforidhit.²¹ Sipas albanologut të respektuar Robert

“Jisuj pra përsëri u foli atyre, dyke thënë, ‘Unë jam drit’ e botësë, ay që më vjen pas, nukë dot’ ecënjë nd’ errësirët, po dotë këtë dritën’ e jetësë.”

- Një varg nga përkthimi i Kristoforidhit i Ungjillit

“Këto përkthime shërbyen si një bazë për krijimin e një gjuhe letrare moderne, në dy variante dialektesh.”

- Robert Elsie, albanolog

Elsie, “Këto përkthime shërbyen si një themel për krijimin e një gjuhe letrare moderne, në dy variante dialektesh.”²²


Ato u përdorën në shkollën e parë shqipe në Korçë (çelur në vitin 1887) dhe në shkollën e vajzave, po aty në Korçë (çelur në vitin 1891).²³

Gjithashtu, këto përkthime shërbyen për të bërë të mundur që mijëra shqiptarë të njihnin Jezun Krishtin, duke lexuar Fjalën e Perëndisë në gjuhën e tyre amtare. Kjo punë thelbësore nuk do të realizohej pa angazhimin e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja.

ALEKSANDËR TOMSONI DHE LIBRASHITËSIT SHËTITËS

KONTRIBUTI KRYESOR:

*Shpërndarja e Biblës në gjuhën shqipe.
Nxitja e hapjes së shkollave në gjuhën shqipe.*



ALEKSANDËR TOMSONI

Ndërsa situata politike në trevat shqiptare ishte ende e paqëndrueshme, një ungjillor skocez do të përfshihej shumë me Shqipërinë dhe do të jepte një kontribut të rëndësishëm për popullin e saj. Rev. Aleksandër Tomsoni u lind në Skoci në vitin 1820. I ati ishte predikues. Pas një shkollimi në universitetet më të mira të Skocisë, Tomsoni u shugurua misionar në vitin 1845. Për 17 vjet punoi mes judenjve në Budapest dhe Stamboll, deri në vitin 1860, kur filloi punën me Shoqërinë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, si drejtor i veprimtarisë për Perandorinë

Osmane. Në këtë rol ai mbikëqyri shpërndarjen e afro një milion kopjesh të Shkrimeve, në më shumë se dyzet gjuhë.²⁴

Në vitin 1863, bëri një turne në Bosnjë dhe Shqipëri, duke vizituar qytete si Shkodra, Janina, Delvina dhe Gjirokastra.²⁵ Kjo për Tomsonin ishte fillimi i një dashurie dhe kujdesjeje të veçantë ndaj popullit shqiptar. Më vonë, për të u shkruajt se: “[Ai] vetë ndjen interesin më të thellë në popullin shqiptar dhe mendon për ta se meritojnë një vëmendje më të përgjithshme sesa kanë marrë deri tani.”²⁶ Ai pa nevojat e mëdha shpirtërore dhe fizike të popullit shqiptar, i cili ishte shumë i shtypur dhe i lënë pas dore. Ai besonte se shqiptarët kishin të drejtë të kishin një formë të shkruar të gjuhës së tyre amtare, edhe pse kjo nuk do të kënaqte turqit. Besonte veçanërisht se shqiptarët kishin

nevojë të madhe shpirtërore që ta zotëronin ungjillin në gjuhën e tyre.

Meqë ungjilli ekzistonte tashmë në shqip, ai pa nevojën për njerëz që, jo vetëm të ishin të gatshëm ta shpërndanin atë, por edhe të përkushtonin kohë për t'i mësuar të tjerët se si të lexonin alfabetin e ri.

Gjatë dekadave të ardhshme, Aleksandër Tomsoni, duke punuar për Shoqërinë Biblike, inkurajoi dhe mbikëqyri shumë shqiptarë dhe të huaj që

ndërmorën detyrën e rrezikshme për t'u sjellë shqiptarëve ungjillin në gjuhën e tyre. Kjo punë bëhej sipas këtij modeli: në qytete kyçe si Janina dhe Shkodra, Shoqëria siguronte magazina ku mund të mbanin botimet e tyre të Biblës. Nga këto depo, njerëz të punësuar nga Shoqëria niseshin me kuaj dhe karroca të mbushura me libra dhe udhëtonin nëpër qytetet dhe fshatarat e vendit, duke i shitur ato me çmim të ulët. Librat që shisnin ishin përkthime të Biblës në gjuhë të ndryshe, si turqisht, greqisht dhe tashmë edhe shqip. Këta njiheshin si “librashitësit shëtitës” (colporteurs).

Këtu do të përmendim vetëm dy prej tyre, si shembuj. Z. Herman Ridëli, bashkë me gruan e vet, u vendos në Shkodër, ku hapën edhe një shkollë të vogël. Nga Shkodra Ridëli vizitoi Lezhën, Tiranën, Durrësin, Vlorën, Elbasanin, Beratin, Manastirin, Prizrenin, Deçanin, Gjakovën, Pejën dhe vende të tjera, deri në Janinë dhe Prevezë.²⁷ Z. Davidson bashkë me gruan e vet, u vendos në Janinë, ku hapi një magazinë në maj të vitit 1865. Sipas raportimeve, për muajin e parë magazina ishte e mbushur çdo ditë nga mëngjesi deri në darkë, me vizitorë që donin të lexonin ose të blinin kopje të përkthimeve të ungjillit.²⁸ Davidsoni udhëtoi në fshatrat afër Janinës, në fshatrat e Dropullit, në Lazarat, Libohovë, Gjirokastrë, Tepelenë, Vlorë, Himarë, Dhërmi, Delvinë, Berat, Përmet, Korçë etj. Në vitin 1884 u hap edhe

“Kur mendoj për gjendjen në të cilën ndodhen shqiptarët, më duket se për ta është domosdoshmëri e madhe të kenë shkolla ku fëmijët të mësojnë gjuhën amtare me Fjalën e Perëndisë dhe ku ne t'u predikojmë atyre Shpëtimtarin Jezus...”

**- Aleksandër Tomson,
cituar në, Gjerasimi -
predikues, iluminist,
rilindës, Xhon Kuanrud,
ISShP, fq. 56**

një depo e Shoqërisë në Manastir. Në vitin 1887 lexojmë që në atë moment kishin gjashtë librashitës shëtitës të cilët udhëtonin në vend.

Gjatë udhëtimeve të saj në vendet ballkanike, Edit Durhami shoqëroi një prej librashitëve shëtitës, Thanas Sinën, në një turne të tillë. Ajo shkroi: “Shoqëria [Biblike] kishte leje që të shiste botimet e saj [të Biblës] në Perandorinë Turke, mirëpo turqit nuk e

“Ishte kryesisht prej ndihmës së këtyre botimeve që Shqipëria e Jugut mësoi ta lexonte gjuhën e vet.”

**Edit Durham,
Albania and the
Albanians, fq.188-189**

kishin pritur të bëhej një version shqip! Një udhëtim që unë bëra nëpër Shqipëri bashkë me një librashitës shëtitës pati aventurat e tij. Në një vend malli ynë u konfiskua prej policisë, por ne siguroam një furnizim të ri. Të krishterët, si dhe myslimanët, u dyndën për të blerë librat e ndaluar. Të gjithë donin të lexonin gjuhën e tyre. Mbjaj mend gjatë një mëngjesi shitëm shtatëdhjetë kopje të librit të Zanafillës dhe më kujtohet gëzimi i një xhandari të ri i cili tha që tani ai mund të mësonte vëllanë e tij të vogël të lexonte. Ishte kryesisht prej ndihmës së këtyre botimeve që Shqipëria e Jugut mësoi ta lexonte gjuhën e vet.”²⁹

Gjatë kësaj kohe, zhvillimet politike në Shqipëri kishin një ndikim destabilizues në shoqëri. Udhëtimi nëpër këtë vend ishte shpesh i rrezikshëm. U desh shumë sakrificë nga ana e burrave dhe grave që punuan për të sjellë ungjillin në Shqipëri. Kjo punë e vështirë dhe sakrifikuese përshkruhet me shënime magjepsëse në librin e vogël *Rrugë Biblike në Shqipërinë e Vjetër*.³⁰ Këta njerëz u përballën me kushte ekstreme moti, me rrezikun e grabitjes nga kaçakët, me burgimin, me kundërshtimin e autoriteteve osmane ose të klerit ortodoks.³¹ Shpesh ata vetë u sëmurën për shkak të këtyre kushteve. Me raste u vdiqën edhe fëmijë.³² Është interesante të lexosh për kohën që u duhej atyre për të udhëtuar atëherë nga njëri vend në tjetrin, krahasuar me sot. Një librashitës shëtitës shënon se udhëtimi nga Gjirokastra në Tepelenë donte 7 orë,³³ udhëtim që sot mund të bëhet në 25 minuta me makinë. Në këto kushte, ata udhëtuan në thellësitë dhe në humbëtitat e trojeve shqiptare, të cilat, le të mos harrojmë, përfshinin atëherë edhe krahinat

e Janinës, Maqedonisë Perëndimore dhe të Kosovës!

Nuk ishin vetëm të huajt që ndërmorën këtë punë, por edhe shqiptarë, si p.sh. Konstandin Kristoforidhi (të cilin e kemi përmendur më lart), Gjon Ciku, Gjergj Qiriazhi, Kristo Qiriazhi, Thanas Sina, Elias Zarifzapasi, Luka Tira, Pandeli Sina dhe Gjerasim Qiriazhi.

GJERASIM QIRIAZI (1858 - 1894)

KONTRIBUTI KRYESOR:

*Hapja e Shkollës së Parë Shqipe të Vashave
Predikimi i ungjillit në gjuhën shqipe
Themelimi i “Vëllazërisë Ungjillore”*



GJERASIM QIRIAZI

Familja Qiriazi është mjaft e njohur te shqiptarët. Madje, gjatë komunizmit, u realizua filmi Mësonjëtorja, bazuar në jetët e Sevastisë dhe Gjerasimit (ndonëse në të u përdoren pseudonime). Ajo që shumë njerëz nuk e dinë dhe që filmi nuk e paraqet, është se një pjesë e familjes Qiriazi, duke përfshirë Gjerasimin, Sevastinë dhe Gjergjin, ishin të krishterë ungjillorë.

Kontributi i tyre ndaj pavarësisë së Shqipërisë ishte i madh, përmes përpjekjeve të tyre për të dhënë mësim në gjuhën shqipe. Por ata nuk ishin të motivuar për ta bërë këtë vetëm nga patriotizmi, por nga një dëshirë për t'i bërë shqiptarët të aftë të lexonin ungjillin në gjuhën e tyre amtare. Një vështrim i thjeshtë i shkrimeve të tij, do ta vërtetojë këtë. Për shembull, te libri *Hristomathi* ai shkruan: “Kurrë të mos pandejmë se vetëm dituria do të sjellë mirësinë e botës pa e bashkuar me Ungjillin, që mund të ndriçojë jo vetëm mendjen, po edhe shpirtin e njeriut...”³⁴

Gjerassim Qiriazi u lind më 1858, pranë Manastirit. Në 1873 ai pati kontakt me ungjillin kur dy misionarë amerikanë erdhën në Manastir dhe morën me qira shtëpinë në krah të asaj të prindërve të tij. Në fillim, Gjerassimi i ri shkonte bashkë me djemtë e tjerë për të prishur takimet,

por filloi ta konsideronte seriozisht mesazhin. Ai bleu një Dhiatë të Re, të cilën e lexoi me kujdes. Kjo çoi në kthimin e tij në besim dhe u bë pjesë e kishës ungjillore atje në vitin 1877.

Shumë shpejt u bë e qartë që Gjasimi kishte një dëshirë të fortë për të ndarë lajmin e mirë të Jezu Krishtit me të tjerët. Në vitin 1878 hyri në shkollën teologjike të misionit, në Samokov të Bullgarisë. Gjasimi u diplomua në vitin 1882, duke lënë pas një “nam të shkëlqyer për dituri, aftësi, besnikëri, gjenialitet dhe përdëllim fetar”.³⁵ Pas diplomimit, vajti në Shkup për të predikuar në gjuhën bullgare, por kishte një dëshirë të zjarrtë t’u predikonte bashkatdhetarëve të tij në gjuhën e tyre dhe të tij.

Gjasimi kishte dëgjuar për Aleksandër Tomsonin dhe se ai kishte të njëjtën dëshirë për t’u sjellë shqiptarëve ungjillin. I shkroi atij duke i sugjeruar bashkëpunim. Gjasimi propozoi të vizitonte të gjitha qytetet kryesore dhe fshatrat e mëdha të Shqipërisë, duke marrë ungjillin e botuar nga Shoqëria Biblike. Me një përkim të mrekullueshëm, pikërisht në të njëjtën kohë, Tomsoni i kishte shkruar Gjasimit saktësisht të njëjtin sugjerim! Letrat e tyre u kryqëzuan rrugës! Pra, bashkëpunimi nisi dhe me “gëzim e shpresë të madhe” Gjasimi, së bashku me një punëtor tjetër të Shoqërisë Biblike, Sevastidin, u nis në turneun e tij të parë në trojet shqiptare.

Gjatë këtij udhëtimi, ai përjetoi edhe kundërshtimin që autoritetet osmane ngrinin ndaj përhapjes së gjuhës shqipe, por pa gjithashtu dëshirën e fortë që shumë prej popullit të tij kishin në zemër për Fjalën e Perëndisë dhe lirinë nga sundimi osman. Në këtë turne të parë, ai lexoi nga ungjilli në mjedise të hapura, dhe shiti shumë nga përkthimet e Kristoforidhit dhe librin e tij të gramatikës shqipe. Për shumë shqiptarë, kjo duhet të ketë qenë hera e parë që dëgjonin Fjalën e Perëndisë në gjuhën e tyre. Së bashku me bashkëpunëtorin e vet, Gjasimi u burgos në Durrës, por u liruan menjëherë falë presionit nga SHBBVH. Ata vazhduan për në Vlorë, Elbasan dhe Tiranë.

Për këtë arsye Ismail Qemali, Mit’hat Frashëri dhe shumë të tjerë, shprehën mirënjohjen e tyre ndaj Shoqërisë Biblike. Në këtë kohë,

ungjijtë dhe librat e gramatikës (të botuara nga Shoqëria për Broshura Fetare apo “Religious Tract Society”) ishin të vetmit libra shqip që autoritetet osmane nuk arritën t’i ndalonin të qarkullonin mes shqiptarëve.

Pas udhëtimit të tij, Gjasimi qëndroi në Stamboll ku studioi gegërishten me Kristoforidhin dhe filloi të shkruante himne të krishtera në gjuhën shqipe. Çdo të diel, mbante shërbesa adhurimi në shqip. Shumë shqiptarë jetonin në Stamboll në atë kohë, përshtirë edhe shumë rilindas, si vëllezërit Frashëri dhe anëtarë të Komitetit Shqiptar të Stambollit. Gjasimi u njoh me ta. Këtu Gjasimi shprehte dëshirën e tij për të hapur shkolla ku shqiptarët mund të mësonin të lexonin gjuhën e tyre, që të mund të kuptonin ungjillin. Por mbi këtë, dëshira e tij e ngutshme ishte të gjente një mënyrë për t’u kthyer në trojet shqiptare dhe të predikonte ungjillin në gjuhën e nënës.³⁶

Në vitin 1884, Gjasimi i ofroi Shoqërisë Biblike të mbikëqyrte depon e tyre në Manastir. Me miratimin e tyre, Gjasimi u kthye në Manastir me një ngarkesë ungjijsh, që të fillonte këtë detyrë. Aty vazhdoi t’u predikojë bashkatdhetarëve të tij. U mirëprit dhe, për herë të parë në Manastir, Gjasimi dhe Gjon Ciku filluan shërbesat e kishës në gjuhën shqipe. Shumë shprehën dëshirën për të mësuar të lexonin dhe të shkruanin në shqip dhe, së shpejti, u desh të porositeshin më shumë Bibla në shqip nga Stambolli.

Në vitin 1962, Skënder Luarasi shkroi një biografi të Gjasimit që, çuditërisht, përfshinte paragrafin e mëposhtëm, i cili shënon se si e perceptonin fëmijët Gjasimin: “Fëmijët në lagje shpesh i afroreshin. Gjasimi mbyllte librin e tij, i përqafohte dhe niste bisedën me ta për gjëra të afërta për zemrat e tyre. ‘Ai flet si Krishti!’, tha një nga vogëlushët. Shumë prej këtyre

“Sapo kisha filluar që të punoja për popullin tim dhe dëshira që t’u predikojë Fjalën e Jetës më shtoej dita-ditës... Zemra nuk më qante as për pasuri e as për kënaqësi trupore. Në mendje kisha vetëm një gjë - përhapjen e dritës ndër popullin tim.”

- Gjasim Qiriaz
Pengu i Kaçakëve,
ISSHP, fq.23.

që vinin nga shtëpi shqiptare, ku flitej shqip, të dielave shkonin te salla e misionit protestant, kur mësonin se do të predikonte Gjerasimi, që ata ta dëgjonin atë ‘të fliste si Krishti’.”³⁷

Ndërsa Gjerasimi ishte në një udhëtim të lodhshëm për në Korçë, karrocieri papritur e ngadalësoi shpejtësinë në grykën e Lajthizës. Disa minuta më vonë u shfaq një bandë kaçakësh udhëhequr nga kriminel i famëkeq Shahin Matraku. E gjitha dukej e planifikuar. Pasi e rrëmbyen, e detyruan të shkruante këtë shënim për ta liruar me shpërblim:

“PRINDËR TË DASHUR,

*Jam peng në duart e kaçakëve;
kërkojnë pesëqind lira shpërblim.*

Gjerasim D. Qiriaz

Mali i Thatë, 3 nëntor 1884” ³⁸

Të rraskapitur dhe të uritur, ata e merrnin me vete zvarrë nëpër male, duke pritur për lajmin e shpërblimit, të cilin Gjerasimi ua kishte shpjeguar se nuk do të vinte, pasi familja e tij ishte e varfër. Në këtë situatë të dëshpëruar, mendimet e tij të trazuara janë regjistruar në vetë fjalët e tij. Ato janë prekëse dhe zbulojnë motivin e tij në jetë: “Në kokë më vërtitej mendimi: “Si do t’i vejë filli kësaj pune?” Mendja më thoshte se nuk do të shpëtoja gjallë. Jo vetëm ngaqë s’kisha para, por në këtë dimër të acartë një sëmundje do të mjaftonte që ta mbyllja jetën në këto male, pa një vend për t’u çlodhur e rob në duart e kaçakëve. Më shumë se jeta më dhimbsej puna e lënë në mes. Sapo kisha filluar që të punoja për popullin tim dhe dëshira që t’u predikoja Fjalën e Jetës më shtoej dita-ditës... Zemra nuk më qante as për pasuri e as për kënaqësi trupore. Në mendje kisha vetëm një gjë - përhapjen e dritës ndër popullin tim. Përse të më harronte Perëndia kështu? Teksa vrisja mendjen me të tilla mendime, diku tutje më zuri syri një lule të bukur që kishte çarë shtresën e borës dhe ngrihej dy gisht mbi të. Me të parë atë lule, ndala dhe e kundrova me endje... Me vete thashë: ‘Nëse Perëndia kujdeset për këtë lule, gati të padukshme e pa vlerë për syrin e njeriut, dhe i fal asaj bukurinë, ç’mund të bëjë Ai për ata që i besojnë?’ Në mendje më erdhën fjalët e ungjillit: ‘Pa shikoni si hedhin shtat zambakët e fushës, ata as lodhen e as tjerren. E pra, as vetë Solomoni, me gjithë lavdinë e tij, nuk ishte stolisur si

ata. Prandaj, nëse Perëndia stolis barin e fushave, që sot është e nesër mund të hidhet në furrë, a s'do t'ju stolisë ai edhe ju, o besimtarë të dobët?" (Mateu 6:28-30). Në ato çaste ato fjalë morën një kuptim edhe më të qartë. Ishte një mësim i vyer për mua. Mora zemër..."³⁹

Pas gjashtë muajsh të hidhur në robëri, më në fund u sigurua lirimi i Gjerasimit, por mbeti i dobët nga ana shëndetësore. Madje, besohet se kjo ngjarje ka ndikuar në dobësimin e tij fizik dhe në vdekjen e tij të parakohshme në vitin 1894. Pas lirit të tij nga kaçakët, në vend që të hiqte dorë nga puna, vendosmëria e Gjerasimit për të përhapur ungjillin vetëm sa u rrit për arsye se besonte që ishte e vetmja kurë e sigurt për mjerimin shoqëror të popullit të tij.⁴⁰ Gjatë viteve në vazhdim, ai udhëtoi shumë në viset shqiptare, duke predikuar ungjillin në shqip. Më 24 mars 1890, Gjerasimi u martua me Athina Mikelidhin, vajzën e pastorit të kishës protestante në Selanik. Në prill Gjerasimi u shugurua zyrtarisht si "ungjilltar i popullit shqiptar".⁴¹

Së bashku me të motrën, Sevasti Qiriazin, hapi Shkollën Shqipe të Vashave, në vitin 1891, dhe një vit më vonë, themeloi Vëllazërinë Ungjillore. Ndër mësueset e para të Shkollës së Vashave ishin Sevasti dhe Parashqevi Qiriaz, Fanka Efthimi dhe Polikseni Luarasi.

Sipas Sevastisë, kundërshtimi prej armiqve të gjuhës shqipe po merrte një formë ogurzezë. Ajo shkruan: "Në kohën kur unë arrita në Korçë, të mbyste propaganda greke dhe madje edhe në vetë atmosferë mund të thithje një ajër kërcënues kundër çdo lloj përpjekjeje për t'i shkolluar njerëzit në gjuhën amtare. Madje peshkopi shkoi deri atje sa të predikonte kështu të dielave: 'Urdhërimi i Zotit është që të gjithë të krishterët duhet të studiojnë vetëm gjuhën greke dhe të adhurojnë vetëm në greqisht, pasi Perëndia nuk kupton shqip dhe nuk e pranon adhurimin në gjuhën shqipe.'" Dhe: "Patriarku u përpoq me gjithë llojet e intrigave me qëllim që të nxiste qeverinë turke të mbyllte shkollën tonë. Më pas ata filluan me mallkime e përndjekje, madje shkuan edhe aq larg sa të vendosnin të vrisnin vëllanë tim. Pavarësisht gjithë kësaj kundërshtie, ne vendosëm të luftonim deri në fund." ⁴²

Në verë të vitit 1892, dikush filloi të ndiqte Gjerasimin dhe në dhjetor

*“Pavarësisht gjithë
kësaj kundërshtie, ne
vendosëm të luftonim
deri në fund.”*

**Sevasti Qiriazhi (Dako),
Jeta Ime, ISShP,
fq.113-116**

hyri në shtëpinë e tij një burrë i armatosur që, me sa duket, ishte dërguar për të vrarë Gjerasimin. (Kjo skenë është portretizuar gjithashtu në filmin *Mësonjëtorja*). Gjerasimi dhe Sevastia ishin të bindur se autori i vërtetë i komplotit ishte peshkopi. Vrasësi kishte pirë që të gjente guxim, por fatmirësisht s’e realizoi dot vrasjen, pasi ishte i

dehur! Më vonë, atë vit, pjesërisht për shkak të shëndetit të rënë që kishte patur që nga koha kur ishte marrë peng dhe pjesërisht për shkak të një tërmeti që e detyroi të flinte jashtë, Gjerasim Qiriazhi ra i sëmurë dhe vdiq më 2 janar 1894, në moshën 35-vjeçare. Stresi i kërcënimeve ndaj jetës së tij duhet të ketë luajtur gjithashtu një rol negativ.

Është shënuar se, pavarësisht vuajtjeve të tij, në shtratin e tij të vdekjes ai mbeti plot me ngushëllim, me gëzim në Zotin dhe ndjeu guxim të ri për t’u folur drejtpërdrejt dhe me ngut vizitorëve të tij për shpëtimin e madh nëpërmjet Jezusit – kuptohet në gjuhën shqipe.

Poema e tij e mëposhtme përmbledh veprën e jetës së tij:

*Do të punoj për mëmëdhenë,
Gjithë jetën sa të rroj,
Do të zgjoj edhe ata që flenë,
Kështu jetën do ta mbaroj.*

*O vëllezër shqiptarë,
Merrni sot udhën e mbarë,
Punën tuaj mos e harroni,
Koha shkon dhe prapë s’vjen.⁴³*

SEVASTI QIRIAZI-DAKO (1871-1949)

KONTRIBUTI KRYESOR:

*Hapja e Shkollës së Parë Shqipe të Vashave (bashkë me Gjerasimin)
E vetmja delegate femër në Kongresin e Elbasanit
(Kongresi i Shkollave Shqipe) 1909*



SEVASTI QIRIAZI

Fotografia pronë e Niko Kotherjes
Marrë nga libri: *Jeta ime*, Sevasti
Qiriaz, ISShP, fq. 12.

Nga shtëpia e saj në Manastir, me ndihmën dhe inkurajimin e Gjerasimit, Sevastia shkoi në Stamboll për të studiuar në Kolegjin Amerikan për Vajza. Ajo ishte e para grua shqiptare që ka përfunduar një kolegji. Gjatë kohës që ishte atje, arriti të bindte drejtorin e një burgu që ta lejonte të vizitonte patriotin Koto Hoxhi, në birucën e tij. Ajo e përshkruan kështu këtë takim:

“Një vrimë e qelbur! Një vazhdë drite që vinte nga një frëngji diku lart më ndihmoi të shquaj një figurë të mjerueshme...Mbi një rrasë guri, që shërbente si shtrat, mbledhur kruspull një kopicë leckash, rrinte Kotoja!...

Më në fund mora kurajën të mërmërisja: “Tungjatjeta Koto!”

- Kush je ti që po flet me mua? Duhet të jetë ndonjë zë qiellor dërguar prej Perëndisë, për të më thënë fjalë qetësuese për zemrën time të plagosur, - tha ai me një zë të mekur, që mezi dëgjohej...

Roja që më shoqëronte e ndihmoi të ngrihej e të mbështetej pas murit! Këtu arrita të shoh një tablo kaq të mjerueshme, sa ndjeva lot të nxehtë që më rridhnin nëpër faqe...

Fola thuajse duke u mbytur me veten: “Kam ardhur, o atë i nderuar, të të sjell një fjalë trimërimi dhe të të them që, edhe pse të kanë plasur në këtë birucë për të vuajtur këtë torturë mizore, prapëseprapë fara që ti ke mbjellë po jep fryte të mira, si edhe të them se shpirti yt jeton në zemrën e popullit tënd.”

- Po. Ma kanë lidhur trupin me vargonj, por shpirti im është i lirë. Është i lirë dhe nuk ka torturë që të më ndalojë së bërtituri: ‘Jo, Shqipëria nuk do të humbë. Shpejt ajo do të jetë e bashkuar, e pavarur dhe e lumtur.’”⁴⁴

Në ceremoninë e diplomimit të saj, Naim Frashëri foli dhe tha: “Motër, ti nuk mund të bësh për Shqipërinë punë më të mirë se kjo që tashmë ke vendosur të bësh së bashku me vëllanë tënd për emancipimin e grave të vendit tonë të vogël dhe të varfër.”⁴⁵ Pasi përfundoi studimet, së bashku me Gjerasimin, themeloi në Korçë Mësonjëtorën e Vashave në vitin 1891, duke e përdorur Dhiatën e Re shqipe si tekstin e parë shkollor. Sevastia dhe Gjerasimi ishin të bindur se ishte e drejta e fëmijëve të mësonin të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën e tyre amtare. Shkolla u njoh jozyrtarisht si “Pishtari flakërues i Shqipërisë”. Kur vdiq Gjerasimi, Sevastia vazhdoi punën me heroizëm, pavarësisht kërcënimeve të vazhdueshme prej autoriteteve turke dhe klerit grek. Një ditë, kur erdhi shefi i policë së bashku me katër policë të tjerë dhe xhandarë për të konfiskuar librat dhe të mbyllin shkollën, Sevastia i ndaloi te pragu i portës, duke e bllokuar rrugën me trupin e vet. Pas dy orësh debat, ata u larguan. Ajo ishte vetëm rreth 23 vjeç!



SHKOLLA E PARË SHQIPE E VASHAVE, KORÇË 1899

Në foto dallohen mësuesja Poliksena Luarasi dhe mësuesi atdhetar Thanas Sina.

Sevastia u martua me Kristo Dakon në vitin 1910. Në vitin 1912, në Manastir, Sevasti Qiriazhi botoi një *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare* dhe në vitin 1917 *Mjeshtërija për të shkruarë letra*.⁴⁶ Shkolla e Vashave në Korçë u mbyll në vitin 1914, me fillimin e Luftës së Parë Botërore.

Në vitin 1922, bashkë me motrën e saj Parashqevi, themeloi Institutin “Qiriazhi” në Tiranë, shkollë e cila ishte e ngjashme me liceun francez në Korçë. Në vitin 1927, Instituti u zhvendos në Kamëz, ku u zgjerua për të përfshirë një bibliotekë të pasur, një kompleks sportiv dhe një program më të gjerë edukimi. Shkolla u vizitua nga disa prej njerëzve më të rëndësishëm të kohës, duke përfshirë Fan Nolin, Mbretin Zog dhe Xhafer Ypin, të cilët ngeleshin të habitur nga fryma dhe standardi i shkollës.⁴⁷

Për rolin e tyre të madh që Sevastia, bashkëshorti i saj, Kristo Dako, dhe Parashqevia patën në historinë e Shqipërisë, u dekoruan me Urdhërin e Skënderbeut në vitin 1931.⁴⁸ Megjithatë, për shkak të lidhjeve të tyre me perëndimin dhe të besimit të tyre fetar, pas Luftës së Dytë Botërore, Partia Komuniste i pa me një sy tjetër dhe u persekutuan rëndë. Kjo është paksa ironike, duke marrë në konsideratë se gjatë luftës ishin nazistët që e keqtrajtuan familjen Dako (Qiriazhi), për shkak se ishin patriotë. Në vitin 1943, Gestapoja kishte arrestuar të gjithë familjen (duke përfshirë edhe mbesën e Sevastisë, Viktorian), siç e shpjegon Xhon Kuanrudi: “Sevastia, asokohe në të shtatëdhjetat, bijtë e saj me gjithë gratë dhe fëmijët e vegjël, si dhe Parashqevia u dërguan të gjithë në një kamp përqendrimi pranë Beogradit.”⁴⁹

Viktoria Ruli (Dako) kujton: “Kushtet në kamp ishin të tmerrshme. Ushqimet ishin lakra dhe lëkura patateash të ziera, nga të palarët shumë morra, pleshta e tartabiqe, rrezikova disa herë të vdisja nga uria... Sevastinë dhe Parashqevinë i merrnin vazhdimisht në pyetje pse i kishin sjellë aty...”⁵⁰

Ata mbijetuan dhe, pas një udhëtimi të gjatë dhe të vështirë, u kthyen në Shqipëri në vitin 1945. Por, edhe pse më në fund ishin kthyer në atdhe, vuajtjet e tyre nuk kishin mbaruar. Fakti që ata kishin qenë patriotë dhe që kishin kontribuar kaq shumë për kombin, u shpërfill brutalisht. Prona e Institutit “Qiriazhi” u konfiskua për t’u bërë Shkolla e Partisë dhe motrat Qiriazhi u dëbuan prej shtëpisë së tyre dhe u detyruan të

jetonin në një kotec pulash. Kristo Dakoja kishte vdekur në fillim të luftës dhe ishte varrosur brenda kopshtit të Institutit. Sipas mbesës së Sevastisë, Viktoria Ruli (Dako), trupi i Kristos u zhvarros dhe koka e tij, e mbështjellë me lecka u përdor si top futbollit për një ndeshje në rrugë nga nxënësit e Shkollës së Partisë (komuniste). Djemtë e Sevastisë u arrestuan dhe, Gjergji, një kirurg mjaft i njohur, vdiq në burg duke mos qenë në gjendje të duronte torturat. Trupi i tij u hodh në një varr masiv pranë Lumit të Tiranës, kështu Sevastisë iu mohua varrimi i të birit. Sevastia dhe Maria, e shoqja e Gjergjit, gërmuan në baltë me thonj për të gjetur trupin e Gjergjit gjatë natës. Më në fund e gjetën dhe lanë një gjurmë për të shenjuar vendin, në mënyrë që të ktheheshin në mbrëmje për ta varrosur. Por kur u kthyen ditën tjetër, vendi ishte punuar me traktor dhe trupi i Gjergjit nuk u gjet më kurrë. Sevastia vdiq në vitin 1949 “e dëshpëruar dhe me zemër të plagosur.”⁵¹

Më vonë, Partia Komuniste pati paturpësinë për ta bërë Sevastinë heroinë të kombit, duke bërë edhe filmin “Mësonjëtorja” për jetën e saj, edhe pse Partia vetë e kishte përndjekur kaq keq. Anton Çefa komentoi: “Për oportunitet dhe hipokrizi politike të pushtetarëve, më vonë, asaj i dhanë titullin ‘Mësuese e Popullit’.”⁵² Sot, le ta vlerësojmë me sinjeritet dhe mirënjohje të thellë punën e madhe që kjo besimtare ungjillore fisnike bëri për Shqipërinë!

“Korçës i kishte dalë emri si qyteti ku ndodhej e vetmja shkollë shqipe në jug të vendit, që qëndronte e hapur me gjithë kërcënimet e turkut apo të grekut. Atë e drejtonte Zonjusha Qiriazi (tani zonja Dako) një mësuese trimëreshë, mjaft e aftë dhe aq entuziaste sa meriton vlerësimet më të larta. Kjo shkollë ishte gjithmonë plot me nxënës, ndonëse po ta vazhdoje atë, si për prindërit ashtu edhe për nxënësit vetë do të thoshte që të përndiqeshin nga turqit ose të shkishëroheshin nga prifti grek. Vajzat mësonin të shkruanin e të lexonin në gjuhën shqipe, të cilën ua mësonin pastaj vëllezërve të tyre.”

**- Edit Durham,
Njëzet Vjet Ngatërresa Ballkanike,
fq. 347 (fq. 108 në anglisht)**

GJERGJ QIRIAZI (1868 - 1912)

KONTRIBUTI KRYESOR:

Nënkryetar i Klubit “Bashkimi” në Manastir

Zëvendëskryetar i Kongresit të Manastirit (1908)

Delegat në Kongresin e Elbasanit (1909)

Anëtar themelues i Komitetit të Bajo Topullit “Për lirinë e Shqipërisë”



GJERGJ QIRIAZI

Gjergj Qiriazi, si vëllai i tij Gjerasimi, ishte një besimtar i bindur që predikonte me guxim ungjillin e Krishtit në gjuhën shqipe. Ai studioi në Kolegjin Amerikan në Samokov, Bullgari, dhe punoi për Shoqërinë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, duke menaxhuar depon në Manastir dhe duke shpërndarë Bibla në shqip dhe libra gramatike. Kjo punë nuk ishte pa rrezik. Gjergji u arrestua nga autoritetet në Manastir dhe në Selanik.

Gjithashtu, Gjergj Qiriazi u bë një figurë tepër e rëndësishme në lëvizjen kombëtare. Në vitin 1905 ishte anëtar themelues i komitetit të fshehtë të Bajo Topullit “Për lirinë e Shqipërisë” që punonte për pavarësinë, së bashku me Grigor Cilkën, Nuçi Naçin, Mihal Gramenon etj..⁵³

Një prej kontributeve më të rëndësishme të Gjergjit, ishte drejtimi i shtypshkronjës së Manastirit, e cila shtypte gazetën patriotike “Bashkimi i Kombit”, furnizonte shkollat me tekste dhe botonte libra biblikë, himne të krishtera dhe broshura që shpjegonin besimin ungjillor – siç është *Të vërteta fillestare për shpëtimin e shpirtit dhe Një tregim i shkurtër i atyre gjërave që na mëson Shkrimi i Shenjtë*

(të ribotuar në fund të këtij libri). Gjergj Qiriazhi botoi *Hristomathi* (1902), *Këngë të Shenjtëruara*, përktheu librin *Udha e Shtegtarit* i Gjon Bunianit, si dhe vepra të tjera.

Gjergji pa nevojën e madhe që të zgjidhej një alfabet i përbashkët për botimet dhe mësimet shqip dhe filloi të bënte thirrje që nga viti 1901, që të bëhej një kuvend e të zgjidhej ky problem. Mishërimi i kësaj thirrjeje ishte Kongresi i Manastirit në vitin 1908, në të cilin Gjergji ishte zëvendëskryetar. Në vitin 1909, Gjergj Qiriazhi ishte delegat në Kongresin e Elbasanit.

Edit Durhami u njoh me familjen Qiriazhi dhe kishte një shoqëri të ngushtë me ta, sidomos me Sevastinë. Në lidhje me Gjergjin, Edit Durhami e përshkruan si “një burrë të kultivuar dhe një shqiptar patriot...”⁵⁴

“Gjergj Qiriazhi - një burrë i kultivuar dhe një shqiptar patriot...”

- Edit Durham,
Albania and the Albanians, fq.212

GRIGOR CILKA (1875-1918)

KONTRIBUTI KRYESOR:

Predikoi dhe dha mësim në shqip.

Shpërndarja e Biblës në gjuhën shqipe

Pastori i tretë i kishës ungjillore në Korçë.

Anëtar themelues i Komitetit të Bajo Topullit “Për lirinë e Shqipërisë”

Delegat dhe folës në Kongresin e Manastirit në vitin 1908



GRIGOR CILKA

Grigor Cilka me të bijën
(Mount Holyoke College, Digital
Exhibits of the Archives and
Special Collections)

Grigor Cilka është një tjetër burrë në të cilin besimi te Krishti dhe dashuria për kombin e vet kanë punuar krah për krah. Ai luajti një pjesë të rëndësishme në përpjekjen e Shqipërisë për pavarësinë dhe ishte mik i ngushtë dhe bashkëpunëtor i familjes Qiriazi dhe rilindasve të tjerë të kohës së tij.

Para viteve 1900, Grigor Cilka kishte shkuar në Nju-Jork për të studiuar në Seminarin Teologjik të Unionit dhe, pas përfundimit të studimeve, nuk qëndroi në SHBA, por u kthye në Shqipëri, për të vazhduar punën e ungjillit. Gjatë kohës në SHBA, u martua me Katerina Stefanovën, një besimtare ungjillore bullgare. Në Korçë, Cilka shërbeu si mësues në Shkollën e Vashave dhe u

bë pastori i tretë i kishës ungjillore aty (e cila ishte themeluar nga Gjerasimi). Është regjistruar se edhe kaçakët vinin ta dëgjonin tek predikonte dhe u ndryshuan nga Fjala e Perëndisë.

Më 3 shtator 1901, çifti Cilka u përball me një traumë të madhe, kur Katerina, bashkë me amerikanen Elen Stoun, u morën peng nga revolucionarë maqedonas, të cilët kërkuan një shumë të madhe parash për lirimin e tyre. Katerina ishte pesë muaj shtatzënë kur u mor peng,

dhe e lindi fëmijën në një kasolle në mal! Ato u liruan më 23 shkurt 1902, pasi pengmarrësit morën mbi 65.000 USD. Pas kësaj, Grigori dhe Katerina shkuan në ShBA për disa vjet, por, në vitin 1905, u kthyen përsëri në Shqipëri, për të vazhduar punën që kishin nisur.⁵⁵

Grigor Cilka ishte gjithashtu anëtar themelues Komitetit “Për lirinë e Shqipërisë” (komiteti i fshehtë i Bajo Topullit) që punonte për pavarësinë.⁵⁶ Grigori shkoi në komunitetin shqiptar në Sofje dhe Bukuresht për të ngritur mbështetje dhe anëtarë. Sipas vetë statuteve të tyre, qëllimi i tyre ishte: “Rilindja e Shqipërisë, duke mbjellë vëllazërinë, dashurinë e bashkimin, duke përhapur qytetërimin, me anë të librave që do të shtypen, duke dërguar njerëz në të katër anët e Shqipërisë, që të mbjellin këto ide...”⁵⁷. Dy vjet më vonë, Bajo Topulli ndihmoi vëllanë e vet, Çerçizin, të formonte çetën e Gjirokastrës, të cilës Grigori dhe Katerina Cilka i ofruan strehë në shtëpinë e tyre në Korçë.⁵⁸

Në vitin 1908, Grigori u arrestua dhe u burgos dy herë, por u lirua, besohet në saje të ndërhyrjes së Fineas dhe Violet Kenedit, besimtarë ungjillorë amerikanë dhe misionarë.⁵⁹

Në Kongresin e Manastirit, në nëntor të vitit 1908, Grigori ishte një ndër njëmbëdhjetë njerëzit që u zgjodhën për Komisionin e Alfabetit.

Pas shpalljes së pavarësisë, Grigor Cilka u burgos përsëri, por kësaj here nga serbët për disa muaj.⁶⁰ Në vitin 1914 e gjejmë në Korçë, gjatë pushtimit grek të Korçës. Sipas Kristo Dakos, Cilka mori pjesë në një betejë për çlirimin e qytetit.⁶¹

Grigor Cilka vdiq nga gripi në vitin 1918. Ajo që ngjelet gjithmonë e habitshme, në lidhje me Grigor Cilkën, është që, edhe pse kishte gjithë mundësitë që të jetonte jashtë vendit, ai vendosi të vazhdonte punën e tij në Shqipëri, përballë sfidave dhe rreziqave të mëdha. Cilka ishte një mik i

“Cilka ishte zemra dhe shpirti i lëvizjes kombëtare.”

Mihal Grameno,
Kryengritja Shqiptare,
fq. 43-44

ngushtë i Mihal Gramenos, i cili tha për të: “Cilka ishte zemra dhe shpirti i lëvizjes kombëtare, trim guximtar i madh, i padrojtur sido qe e kishin burgosur për këtë qëllim, edhe ishte i ditur. Shërbimet e këtij atdhetari nuk kanë shembull dhe shpagim. Cilka meriton faqe shumë prej historisë kombëtare, duke qenë që ka qenë, është dhe do të vdesë patriot!”⁶²

THANAS SINA (1859-1934)


KONTRIBUTI KRYESOR:

Pastor dhe predikues në gjuhën shqipe

Shpërndarja e Biblës në gjuhën shqipe

Përkthimi dhe redaktimi i librave shqip

*Një prej mësuesve të parë të Shkollës së Djemve në Korçë,
drejtori i dytë i saj dhe Mësues në Shkollën e Vashave në Korçë*



THANAS SINA

Thanas Sina lindi në Postenan, një fshat në veri-perëndim të Leskovikut dhe shkoi në Janinë në shkollën “Zosimea”.⁶³ Sina u bashkua me Pandeli Sotirin dhe Thoma Avramin, për të hapur Shkollën e Djemve në Korçë në vitin 1887. Sina ishte zëvendësdyrëtor. Emri i shquar i Pandeli Sotirit është shumë i lidhur me këtë shkollë, mirëpo Sotiri mbushi vetëm gjashtë muaj në këtë detyrë dhe pastaj u largua për në Greqi, duke lënë Thanas Sinën si dyrëtor të shkollës.⁶⁴

Në Korçë, Thanas Sina u anëtarësua në kishën ungjillore, e cila drejtohej nga Gjerasim Qiriazhi. Në vitin 1891, Sina iu bashkua radhëve të librashitësve shëtitës të Shoqërisë Biblike, duke çuar ungjillin në gjuhën shqipe në qytete të ndryshme dhe duke predikuar mesazhin e tij. Kjo nuk ishte pa pasoja: u arrestua të paktën dy herë nga autoritetet osmane. Thanas Sina ishte shqiptari, të cilin e shoqëroi e famshmja Edit Durham, gjatë udhëtimit të parë të saj në trojet shqiptare, të përshkruar në librin *Brenga e Ballkanit*. Durhami e përshkruan Thanasin kështu: “Ishte gjithnjë i qeshur, i gatshëm për ndihmë dhe mirëdashës... I jam shumë mirënjohëse.”⁶⁵

Aleksandër Tomsoni i SHBBVH, herë pas herë kërkonte ndihmën e Thanasit për përgatitjen e botimeve të pjesëve të Biblës në gjuhën shqipe. Ka patur bashkëpunim të ngushtë me Gjerasim Qiriazin dhe, kur Gjerasimi vdiq në vitin 1894, Thanas Sina u bë pastori i dytë i kishës ungjillore në Korçë.⁶⁶

FINEAS DHE VIOLET KENEDI



FINEAS DHE VIOLET KENEDI

Çifti Fineas dhe Violet Kenedi ishin të krishterë ungjillorë amerikanë, të cilët erdhën në Korçë në vitin 1908, me Misionin Kongregacional Amerikan, me kërkesë të Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit.

Kenedit mbërritën në Korçë në kohën kur Grigor Cilka (pastor i kishës ungjillore)

sapo ishte burgosur. Menjëherë Fineasi nisi të hetonte arrestimin e Cilkës dhe arriti në përfundimin se ishte i pajustificueshëm dhe ishte bërë si rezultat i presionit nga interesat greke dhe osmane. Ai e vizitoi Cilkën në burg çdo ditë dhe pa me sytë e tij kushtet e të burgosurve – të mbajtur pa gjyq dhe vetëm me bukë për të ngrënë, burgjet të mbipopulluar. Kenedi shkoi si tek autoritetet turke, ashtu edhe te peshkopi grek, për të bërë apel për lirimin e Cilkës.⁶⁷

Puna kryesore e çiftit Kenedi ishte predikimi i ungjillit, por gjithashtu, në mënyrë të tërthortë, mbështetën lëvizjen kombëtare shqiptare. Fineasi nisi të predikonte në shqip. Është e qartë që ai e kuptonte domethënien politike të kësaj. Ai shkroi: “Herët a vonë, zyrtarët e qeverisë do ta kundërshtojnë predikimin tim, sepse ata e konsiderojnë përdorimin e shqipes si një pikëpyetje politike. Atëherë, unë duhet të qarkulloj shkrimet dhe natyrisht forma në latinisht (ose shqip) është ajo që dua të përdor. Ata do ta kundërshtojnë këtë... përdorimi i gjuhës shqipe është një ofendim politik.”⁶⁸ Ai raportoi se njerëzit dënoheshin nga autoritetet, për shkak të zotërimit të librave shqip, përfshirë edhe kopje të Biblës. Pesë mijë kopje të predikimeve të tij të shkruara u botuan në vitin 1912 nga Gjergj Qiriazit në Manastir dhe u shpërndanë.

Në vitin 1910, Fineasi erdhi në ballë të luftës për pavarësi, kur

autoritetet turke u përpoqën përsëri të mbyllnin të gjitha shkollat në gjuhën shqipe. Si qytetar amerikan, Fineasi ishte në gjendje të shpallte imunitet ndaj këtij ligji dhe kështu Shkollës së Vashave në Korçë iu dha emri “Shkolla Amerikane” Fineasi mundi ta mbante të hapur. Në atë kohë ishte e vetmja shkollë shqipe që funksiononte në vend.⁶⁹

ÇARLS TELFORD ERIKSONI (1867-1966)

*Informimi i opinionit publik në botë për Shqipërinë
Delegat i “Vatrës” për Shqipërinë në
Konferencën e Paqes në Paris (1919)
Hapja e Shkollës Bujqësore në Kavajë për djem
Hapja e Kolegjit të Vajzave në Kavajë
Delegat i “Vatrës” në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për
Organizimin Ndërkombëtar, San Francisko 1945.*

Çarls Eriksoni ishte një misionar dhe predikues i shuguruar që erdhi si misionar në Shqipëri, në vitin 1908, me Bordin Amerikan për Komisionerët e Misioneve në Vendet të Huaja (një organizatë misionare e themeluar nga besimtarë ungjillorë). Kur erdhi, Eriksoni menjëherë derdhi gjithë energjinë dhe pasionin e tij në ndihmesën e popullit shqiptar, por kontributet e tij më të rëndësishme u dhanë pas vitit 1912. Megjithëse pavarësia tashmë ishte shpallur, ajo do të rrezikohej herë pas here në vitet që do vijonin dhe shteti i ri i Shqipërisë do të kishte nevojë për miq të mirë dhe bashkëpunëtorë. Eriksoni ishte një nga miqtë më të mirë të Shqipërisë, në kohën e nevojës së saj më të madhe. Ai pa gjendjen e varfër të popullit shqiptar në atë kohë, vuajtjen e tyre për shkak të sundimit osman, rrezikun e copëtimit, mungesën e arsimit, dhe menjëherë ndjeu thellë një dëshirë të ndihmonte sido që mundej. Eriksoni kuptoi që sundimi osman pengonte përmirësimin e gjendjes së popullit shqiptar dhe, për këtë arsye, ishte shumë “pro” pavarësisë së Shqipërisë. Gjatë kohës së tij në Shqipëri, Eriksoni u përball me kërcënim, kundërshtim, sëmundje dhe tragjedi. Kontributet

“Kur shoh prapë në këto 52 vjet trazirash, e gjej të pamundur t’i gjej fundin punëve të panumërta që ai [Eriksoni] ka bërë për popullin shqiptar, në daç si udhëheqës shpirtëror, edhe si diplomat dhe edukator.”

**- Qerim Panariti (VATRA),
19 janar 1967, cituar në librin
Biografi e Charles Telford
Erickson, M. Berisha, fq. 364**

e tij u dhanë me sakrificë të madhe personale.

Eriksoni filloi misionin e tij në Korçë dhe Tiranë. Udhëtimi ishte jashtëzakonisht i vështirë dhe i lodhshëm.⁷⁰ Eriksoni nuk ishte vetëm, por ishte me gjithë familjen e tij, gruan dhe katër fëmijë të vegjël. (Kurse një fëmijë i lindi në Shqipëri.) Pas një farë kohe në Tiranë, ata u kërcënuan nga mbështetës të xhonturqve⁷¹ dhe u detyruan që të zhvendoseshin në Durrës, dhe pastaj Elbasan. Në Elbasan u përpoq të hapte një shkollë, por qeveria osmane e pengoi në blerjen e tokës.⁷² Në vitin 1910, nën reaksionin osman, u dëbua nga Elbasani për një kohë. Në Manastir e rrahën dhe e futën në burg.⁷³

TURKS BEAT MISSIONARY.

American Assaulted and Arrested Without Cause—Later Released.

BOSTON, Nov. 14.—The American Board of Commissioners for Foreign Missions has received a dispatch announcing that one of its missionaries, the Rev. Charles Telford Erickson, has been beaten and arrested at Monastir, Macedonia.

The report states that after an hour or so of detention the missionary was released, upon the demand of the Austrian Consul, who is acting for the United States in Macedonia. No charges were made against Mr. Erickson.

Secretary Barton attributes the arrest to the desire of the Turkish Government to stifle the ambitions of the Albanians for modern education. The case has been placed in the hands of the American Embassy at Constantinople for adjustment.

Burimi: New York Times,
15 nëntor 1910

Në vitin 1912, i kthyer tashmë në Elbasan, djali i Eriksonit, Ërli, pësoi një aksident dhe, me sa duket, i plasi apendiciti. Duke qenë se në Shqipëri nuk kishte kirurg që ta operonin, Eriksoni u detyrua ta çonte në Itali dhe pastaj në Zvicër. Por, në udhëtimin e gjatë dhe të vështirë, djali u përkeqësua dhe vdiq në spital në Zvicër, pas dy operacioneve dhe shumë vuajtjeve.⁷⁴ Ërli ishte jo vetëm bir, por edhe shok i ngushtë dhe Eriksoni u mërzi shumë për vdekjen e tij. Megjithatë ai kishte shpresë që vdekja nuk do ishte fundi i tij. Këtu shohim pak në lidhje me besimin e tij. Ai shkruan: Ajo agoni e tmerrshme prej së cilës ai vdiq pak e nga pak gjatë gjithë atyre ditëve, ishin veçse dhimbjet e lindjes në një jetë më të madhe, më hyjnore. Nëse nuk do ta besoja këtë, vështirë se mund të shihja çfarë do të më mbante që të vazhdoja me barrën e jetës, dhe të përpiqesha të isha besnik ndaj detyrave të mia. Prandaj lamtumirë derisa të takohemi, biri im, dhe Ati të pastë në kujdesin e tij...⁷⁵

Nga Zvicra, Eriksoni u kthye në Shqipëri më 1 dhjetor të vitit 1912, në portin e Durrësit. Pavarësia Shqipërisë ishte shpallur tashmë, por në Durrës serbët kishin pushtuar portin. Kur arriti te dogana, ata e arrestuan pa i dhënë asnjë shpjegim. Edhe pse ishte dimër, e futën në një dhomë pa dyshek e pa batanije, dhe pa ushqim. Kur kërkoi t'i dërgonte një mesazh të shoqes, të cilën nuk e kishte parë për tetë javë dhe ishte në merak, edhe këtë serbët nuk ia plotësuan.⁷⁶ Pranë dritares kaloi një djalë i vogël dhe Eriksoni arriti që të dërgonte një mesazh me anë të tij te konsulli austriak. Ai e ndihmoi, por prapë pas një jave mezi e lanë që të shkonte në familje, në Elbasan, dhe kjo ishte me kusht që të largoheshin nga Shqipëria brenda njëzet e katër orëve.⁷⁷

Jashtë Shqipërisë, Eriksoni nuk e harroi kauzën me të cilën kishte lidhur jetën e tij. Nëpërmjet vizitave dhe artikujve që shkruante, ai kërkoi ndihmë për refugjatët shqiptarë⁷⁸ dhe nxiste investime financiare në Shqipëri. Ka shkruar në gazeta të ndryshme, si gazeta prestigjioze *The Economist*, duke i treguar opinionit publik të drejtat e shqiptarëve si komb i pavarur.⁷⁹ Në vitin 1913, u nis prapë për në Shqipëri, duke sjellë drithëra në Durrës, për ndihmë.⁸⁰ Në Amerikë, në vitin 1914, ai siguroi premtime për mbështetje financiare për investime dhe projekte të tjera humanitare në Shqipëri. Eriksoni dëshironte të kthehej në Shqipëri dhe të ndërtonte një spital dhe një shkollë, por për momentin ky plan nuk do realizohej. Ishte në Zvicër, kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore.

Gjatë kohës së luftës, Eriksoni shërbeu me Kryqin e Kuq në Itali dhe, për një farë kohe, predikoi në Xhenova. Duke ditur që Kryqi i Kuq nuk kishte ende veprimtari në Shqipëri, kur mbaroi lufta, Eriksoni shkoi në Romë, për t'i kërkuar Kryqit të Kuq që të shkonin në Shqipëri. Ata jo vetëm që pranuan, por e caktuan Eriksonin udhëheqës të misionit të Kryqit të Kuq në Shqipëri. Këtë detyrë të lartë Eriksonit iu desh t'ia linte dikujt tjetër, meqenëse pikërisht në këtë kohë u thirr për një detyrë tjetër. Një telegram i kishte ardhur nga "Vatra" në Boston, ku i kërkohet që të ishte delegat i Shqipërisë në Konferencën e Pages në Paris (1919). Eriksoni pranoi dhe, pas një konsultimi me Ismail Qemalin në Romë, u bashkua me Mehmet Konicën dhe Mihal Turtullin në Paris, që t'u jepnin zë të drejtave të Shqipërisë, si një shtet i pavarur. Njihet gjerësisht se kundërshtimi i Uilsonit ndaj

“Ai ia doli të bindte Presidentin Uilson për të deklaruar se Amerika nuk do të nënshkruante kurrë një dokument përfundimtar të Konferencës së Paqes në Paris, nëse kufijtë e Shqipërisë do të dhunoheshin. Kjo ishte një nga dy kontributet më të mëdha të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në shekullin e njëzetë (e dyta ishte çlirimi i Kosovës në vitin 1999).”

- <http://institutit.org/albanian-jewish-relations-herman-bernstein/>

pretendimeve të Traktit të Fshehtë të Londrës (1915) në Konferencën e Paqes ishte jetik për mbijetesën e shtetit të Shqipërisë. Ajo që është më pak a njohur është se kontributi i Eriksonit ishte një pjesë thelbësore në informimin e Presidentit rreth kësaj çështje.⁸¹ Në fakt, Mal Berisha ka vlerësuar kontributin e Eriksonit kështu: Ai ka qenë anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën

e Paqes në Paris. Unë besoj shumë që vendimi i Presidentit Uilson... ka ardhur bazuar mbi edukimin e përditshëm prej 15 ditësh që atij i ka bërë Charles Telford Ericksoni...⁸²

Pas Konferencës, Eriksoni vazhdoi t'i shërbente Shqipërisë dhe shqiptarëve sido që mundej. Këshillat e tij ndikuan në fusha të ndryshme, që nga ndërtimi i rrugëve, deri tek eksplorimi i naftës së vendit.⁸³ Ka mbajtur pozita të ndryshme: në vitin 1920, u emërua nga qeveria shqiptare “Komisioneri Tregar në Shtetet e Bashkuara” dhe, në vitin 1923, u emërua zyrtar i Legatës së SHBA-së në Tiranë.⁸⁴

Eriksonit iu kërkua që të hapte një kolegji bujqësor në Shqipëri.⁸⁵ Ai pranoi, duke qenë se kishte parë vetë nevojën e madhe për përpërim në metoda bujqësore në vend. Eriksoni hapi Shkollën e Agrikulturës në Kavajë, për djem, me qëllim që të sillte trajnim në metodat moderne bujqësore.⁸⁶ Gjithashtu, hapi edhe një shkollë për vajza në Kavajë ku mësohej: “punëdore, ekonomi shtëpiake, higjienë, si dhe lëndë të tjera të ngjashme.”⁸⁷

Në vitin 1931, Çarls Telford Eriksoni u nderua me Urdhrin e Skënderbeut⁸⁸ dhe një rrugë e Tiranës u emërtua me emrin e tij.⁸⁹ Në vitin 1937, ishte i ftuar nderi në 25-vjetorin e pavarësisë. Në vitin 1945,

Albania Decorates C. T. Erickson.

The Near East Foundation announced yesterday the receipt of information from Kavaja, Albania, that the Order of Scanderbeg was awarded on Tuesday to C. Telford Erickson, founder of the Albanian-American Institute, by Prime Minister Pandeli Evangeli. Dr. Erickson is credited with founding the first college in Albania since the days when Aristotle taught on the streets of Stagira, 2,200 years ago. He is the field representative of the Near East Foundation in the Balkans.

The New York Times

Published: August 7, 1931

Copyright © The New York Times

Eriksoni ishte përsëri delegat i “Vatrës” në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Organizimin Ndërkombëtar në San Francisko, në vitin 1945.⁹⁰ Eriksoni shkroi edhe një histori të Shqipërisë, e cila nuk u botua gjatë jetës së tij. Ky libër është me interes të madh për historianët, sepse Eriksoni ishte dëshmitar gjatë një pjese të historisë së Shqipërisë dhe njihte personalisht shumë nga figurat e saj, si Mbretin

Zog, Fan Nolin, Lef Nosin, Aqif Pashë Elbasanin etj. Eriksoni vdiq më 26 dhjetor 1966.

PASTHËNIE - ÇFARË ËSHTË UNGJILLI?

Përveç vlerës së tij letrare në zhvillimin e gjuhës shqipe të shkruar, mesazhi i ungjillit të Jezu Krishtit ishte frymëzimi më i madh i atdhetarëve të përmendur në këtë libër.

Kjo histori nuk është unike. Kudo nëpër botë njerëzit kanë bërë sakrifica të mëdha personale për t'u sjellë ungjillin të tjerëve. Gjithashtu, janë frymëzuar nga mesazhi i tij për t'i ndihmuar të tjerët. Emra të mëdhenj njerëzish, si Martin Luter King, Nënë Tereza e deri te Majkëll Faradej, të gjithë deklaruan frymëzimin nga ungjilli. Pse ndodh kjo? Çfarë ka ungjilli që është kaq i rëndësishëm, sa që i bën njerëzit të punojnë pa u lodhur, të heqin vuajtje dhe të udhëtojnë deri në skajet e botës, vetëm që të tjerët të dëgjojnë për të? Çfarë ka ai që i frymëzon njerëzit të shfaqin dashuri dhe dhembshuri për të tjerët? E vetmja mënyrë për të gjetur përgjigje për këto pyetje është të kuptosh mesazhin e ungjillit për veten tënde. Këtu japim një artikull të botuar në vitin 1907 nga i krishteri ungjillor shqiptar Gjergj Qiriaz, në librin e tij *Hristomathi*. Pas transkriptimit do të gjeni edhe materialin në origjinal.

NJË TREGIM I SHKURTËR I ATYRE GJËRAVE QË NA MËSON SHKRIMI I SHENJTË

Librat e Dhiatës së Vjetër na flasin për të vetmin e të vërtetën Perëndi, Ledhe na mësojnë se ky Perëndi i gjithëpushtetshëm e i përjetshëm krijoi qiejt, dheun edhe gjithë gjërat; edhe, ndonëse është pafund i drejtë, edhe si i këtillë kërkon dënim për të ligun, është gjithashtu edhe plot me dashuri e me mëshirë; se qeveris gjithë gjërat sipas vullnetit së tij plotësisht të mirë e të ditur.

Këto libra na mësojnë edhe se Perëndia krijoi njeriun e parë, Adamin, sipas ngjasimit e sipas shëmbëllimit të tij, domethënë të drejtë, të pafaj edhe të lumtur. Shohim edhe se Adami, duke u tërhequr nga gënjeshttrat e djallit, i cili e kishte zili për lumturinë e tij, nuk iu bind urdhrat që i kishte dhënë Perëndia, Zoti i tij, edhe se, me anë të kësaj mosbindje,

solli fajin në botë dhe, me anë të fajit, vdekjen. [Këto libra na mësojnë] se për këtë, neve që jemi bij të atij [Adamit], kemi pjesë në natyrën e tij, kemi pjesë edhe në fundin e tmerrshëm të të mosbindurit të atij ndaj urdhrat të Perëndisë; edhe se ne jemi prej veti bij zemërimi dhe nën vdekje dhe nën dënim.

Këto libra, përveç këtyre, na mësojnë se Perëndia i premtoi Adamit, posa ra në faj, pastaj Abrahamit edhe gjithë stërgjyshëve, se do të dërgonte “farën e gruas”, domethënë birin e tij Jezu Krisht, që të shpëtonte nga faji e nga mundimi i fajit gjithë ata, të cilët, me anë të një besimi të vërtetë e të gjallë, do të besonin në këtë premtim edhe do ta prisnin Jezu Krishtin për Shpërblenjës të tyre. [Na mësojnë] se njeriu, meqenëse ishte prej vetvetes plot me krenari e me ligësi, edhe për këtë nuk mund të njihte mjerimin dhe fatkeqësinë e tij, Perëndia i dha me anë të Moisiut Ligjin e tij që, pasi me anë të këtij Ligji t’i tregonte në sy peshën e ligësisë së zemrës së njeriut, të mund ta sillte në një gjendje që të njohë nevojën e ardhjes së Jezu Krishtit në botë, që të na shpëtonte nga mallkimi i Perëndisë për shkeljet tona të Ligjit të tij edhe nga pushteti i fajit mbi zemrat tona. Në gjithë atë kohë që Perëndia dha Ligjin e Shenjtë, urdhëroi edhe kurbanet, edhe ofertat për fajin, të cilat ishin si hije që kishin për qëllim të rrëfenin që përpara kurbanin e madh, të cilin Jezu Krishti do ta jepte me anë të trupit të tij përmbi kryq, që të fshijë dhe të heqë fajet e popullit të tij, e atyre që do të besonin me të vërtetë në të. Me këtë mënyrë Dhiata e Vjetër dëshmon për Jezu Krishtin edhe njerëzit e shenjtë nën besëlidhjen e vjetër, domethënë në kohët përpara Krishtit, besuan në Shpëtimtarin e premtuar, me anë të mësimet që u jepte për atë Fryma e Shenjtë.

Librat e Dhiatës së Re (ungjilli etj.) na mësojnë se Jezu Krishti, që është Perëndi i vërtetë, u dërgua përmbi dhë në kohën e caktuar e të parashikuar prej profetëve; se ky Jezus, Shpëtimtari ynë, erdhi në mish, domethënë u bë njeri i përsosur dhe iu bind plotësisht Ligjit të Perëndisë, duke përmbushur çdo drejtësi; se vuajti edhe vdiq, edhe u ngjall; edhe se çdo gjë që bëri për njerëzit në këtë punë të madhe të mëshirës, e bëri jo se u gjet fajtor nga njerëzit, po që të njihet Perëndia, Ati ynë, besnik në premtimet e tij, duke hapur pasuritë e pafund të hirit të tij, edhe duke trajtuar e numëruar si fajtor për ne Atë që nuk njohu faj, që ne të bëhemi drejtësi e Perëndisë ose të drejtë përpara Perëndisë, me anë të tij.

Këto libra na mësojnë edhe se Jezu Krishti është i vetmi qengj i Perëndisë që heq fajet e botës (Gjoni 1: 29, 36) dhe se erdhi përmbi dhé, që të shpëtojë shpirtrat e të tijëve, të cilët i deshi me një dashuri të përjetshme e, të cilët, me anë të atij, u pritën në hir e në paqtim pranë Perëndisë, që, duke u pritur si bij të atij, të mund të bëhen trashëgimtarë të Mbretërisë së Perëndisë bashkë me Krishtin.

Këto libra na rrëfejnë se, që të mund të çmojmë e ta pranojmë këtë bekim të Perëndisë, ai na bëri pjesëtarë të Frymës së tij të Shenjtë që sjell në zemrat tona besimin në Jezu Krishtin; edhe se, po të mos napërsërilindte kjo Frymë e Perëndisë, duke na qortuar për faj e duke na bindur të sulemi te Jezu Krishti, që të marrim faljen e fajeve tona edhe drejtësinë, atëherë besimi ynë, në ta quajë njeriu kështu, është i vdekur.

Këto libra na vërtetojnë edhe se gjithë ajo Frymë na jep dëshmi e na vërteton se jemi bij të Perëndisë, na bën të kemi me Perëndinë e me njerëzit atë dashuri për të cilën flet Shën Pali në kapitullin 13 të Letrës së parë të Korintasve, edhe bën të lindë në ne një shpresë e patundur se do të fitojmë jetën e përjetshme; përmbi këtë shton se, me anë të këtij besimi që vepron me anë të dashurisë e që tregohet me anë të fryteve të tij, dalim të drejtë e shenjtërohemi, domethënë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht na quan, na numëron e na trajton sikurse të ishim plotësisht të drejtë, edhe ndërkohë vë në zemrat tona shenjtërinë me anë të një veprimi të hirit të tij.

Më në fund shikojmë, me anë të Fjalës së Perëndisë, domethënë me anë të Shkrimit të Shenjtë, se Jezu Krishti erdhi në botë, që, me anë të tij, duke u pastruar prej fajeve tona, të mund të përmbushim vullnetin e tij, duke bërë vepra të mira, e t'i jetojmë nga zemra me drejtësi e shenjtëri tërë ditët e jetës sonë; se Jezu Krishti, duke dhënë për ne te Perëndia gjakun e vetes së tij si ndërmjetës mes Perëndisë dhe njerëzve, është edhe kryepriifti ynë që lutet për ne, që të marrim çdo gjë që kërkojmë nga Perëndia, me besim në emrin e tij.

Shkrimet e Shenjta na vërtetojnë edhe se, po ai Jezu Krisht ka për të ardhur edhe një herë, në një kohë që e ka caktuar Perëndia, që të gjykojë gjithë njerëzit e që t'i japë secilit sipas veprave të tij; atyre që, me anë të një fryti të hirit të atij, do të kërkojnë jetën e shpëtimit e

tyre pranë atij edhe do të presin ardhjen e tij me besim, me shpresë e me gëzim, do t'u thotë këto fjalë të gëzueshme: “Ejani, o të bekuarit e tim eti, trashëgoni mbretërinë që është bërë gati për ju, qëkurse është themeluar bota”; atyre që nuk do të vlerësojnë Fjalën e tij, e do të hedhin tej hirin e tij, do t'u thotë: “Ikni prej meje, të mallkuar, e shkoni në zjarrin e përjetshëm që është bërë gati për djallin e për engjëjt e tij.”

Shkrimi i Shenjtë na u dha me anë të një fryti të hirit të Perëndisë e me anë të veprimit të Frymës së Shenjtë, që, me ndihmën e po asaj Fryme të Shenjtë, të mund të kuptojmë e të besojmë se ka një Perëndi të vetëm e të vërtetë edhe një Shpëtimtar të vetëm që është Jezui Krishti, të cilin Perëndia e dërgoi sipas premtimit të tij, që, gjithë ata që do të besojnë në Atë, të trashëgojnë jetën e përjetshme; edhe Shën Pali thotë se është i mallkuar ai që do të rrëfejë një tjetër besim, një tjetër udhë shpëtimi, përveç asaj që është në Jezui Krishtin; sepse e Tij, si e Atit edhe e Frymës së Shenjtë, është tërë nderi e tërë lavdia, në jetë të jetëve.

Le ta hapim, pra, Shkrimin e Shenjtë me një nderim të madh dhe le ta lexojmë duke iu lutur Zotit që, për dashurinë e Birit të tij të dashur, të na japë Frymën e Shenjtë, që të mund të kuptojmë qartë gjithë sa janë shkruar në të. Le ta lexojmë me kujdes, le të jetojmë me zemër të pastër, sipas porosive të saj, edhe, duke lënë mënjane çdo shpresë të kotë mbi diturinë dhe gjykimin tonë, të kërkojmë në të udhën e jetës së përjetshme. Në këtë libër të Perëndisë do të gjejmë dritën, gëzimin e ngushëllimin për në këtë jetë edhe një siguri lumturie të patundur për orën e vdekjes, edhe vlesën a kaparin e një lumturie të përjetshme pranë Perëndisë, me anë të Jezui Krishtit.

Ne tregim i-çkurtere i atyre perrave qe na meson Kart' e-Çenqteruare.

Vivlat' e Bjates' se-Vjetera na flasene per te-ve-temin' e te-vertetine Perendi eëe na mesojne, se ky Perendi gëde pucëtetes e i-perjeteëm krijoj qiejte, eëe gëde gerrate; eëe ndonesë este pa an' i-drejte eëe si i-ketiëe kerkon mundim per te-ligene, este gëd astu

edhe plot me dæuri e me perdehim; se qeveris ghide
gerrate pas dæurimit te ti pa mase te-mir' e te-diture.

Keto vivla na mesojne edhe, se Përendia krijoi te-
parine heri, Aðamne, pas te-pergajturit' e pas te-ðem-
beleyerit te-ti, do-më-ðene te-drejte, te-pafajm edhe te-
lumure. Coheme edhe, se Aðami, dyke hequrë nga ge-
hestrat' e djalit, i-cili e kishte nakar per lumerin' e-ti,
nuk' u-bint nde urðerit qe i kishte ðene Përendia, Zoti
i tij, edhe se, me ane te keti te-mos-binduri, kalë fajne
nde botet, edhe me ane te fajit vdekjene; se per kete
neve qe jemi bij t' ati edhe kemi pjese nde naturet t'
ati, kemi pjese edhe nde fundet te-tmeruare te te-mos-
bindurit t' ati nde urðerit te Përendise; edhe se neve
jemi prej vetiu bij zemerimi edhe ndene vdekjet edhe
ndene denimt.

Keto vivla pervesh ketyreve na mesojne, se Pë-
rendia ju zotua Aðamit, posa ra nde faj, pastaj Avraa-
mit edhe ghide krye-atervet, se dote dergonte faren' e
gruase, do-më-ðene birin' e-ti lisu-Krist, qe te çpetonte
nga faji e nga mundimi i fajit gidi ata, te-cilete me ane
te qe besë se-vertete e se-galle dote besonine nde keto
te-zotuarë edhe dolë pritrnine lisu-Kristine per Çperblim-
tar te-tyrë; po se heriu më-qene-qe ishte prej vetiu plot
me maðesti e me ligesi edhe per kete nuke muntte te
nhte mjeresin' e fatkeqerin' e ti, Përendia i ða me ane
te Moisiut Nomn' e-ti, qe, pasi me ane te keti Nomi
t' i tregonene faqëza te-renduarat' e-liga te zemerës' se
heriut, te muntte te sillete nde qe gendje qe te qolhe
nevojen' e te-ardhurit te lisu-Kristit nde botet, qe te na
çpetonte nga malëkimi i Përendise per te çkelurite prej
neve te Nomit t' Ati, edhe nga rueteti i fajit mbi zeme-
rat t' ona. Nde gidi ate kohe qe Përendia ða Nomn' e-
Cençteruare urðeroj edhe kurbanete edhe ðuretirate per

fajne, te-cilale iëine si hije, qe këine per qelim te pefenine qe-perpara kurban' e-mad, te-ciline Iisu-Kristi dote epte me ane te trupit te-ti permby kryqt, qe te çuanë e te ngrëre fajet' e lauzit te-ti, e atyreve qe dote besonine me te-vertete mb' ate. Me kete menyre Bjat' e-Vjetere ep deçmim per Iisu-Kristine, eadë qerezit' e-çenferuare ndene ikonomit te-vjetere, do-me-dene nde kohet perpara Kristit, besuane mbe Çpetimtarin' e-zotuar me ane te mesimit qe u epte per ate Frym' e-Çenferuare.

Vivlat' e Bjates' se Re (Ungili etj.) na mesojne, se Iisu-Kristi, qe eote Perendi i-vertete, u-dergua permby dëst nde kohet te-ndar' e te-çenuare prej profitervet; se ky Iisu, çpetimtari yne, erdi nde miç, do-me-dene u-be qeri i-mbaruare eadë u-bint me te-plotte nde Nomt te Perendise dyke mbuëure çdo drejteri; se vuajti eadë vdiq eadë u-ngal; eadë se çdo qe beri per qerezite nde kete pune te-madë te perdeçimit e beri, jo se qohu ndone ve-jëjtje nder qerezite, po qe te qihete Perendia, Ati yne, besetar nde te-zotuarat te-tija, dyke hapure pasjet' e-pa-neta te hirit te-ti, eadë dyke perndorure e numeruare si fajtuar per ne Ate qe nuke qohu faj, qe neve te benëmi drejteri e Perendise a te-drejte perpara Perendise me ane t' Ati.

Keto vivla na mesojne eadë, se: Iisu-Kristi eote i-velemi qenq i Perendise qe ngreh fajet' e bolese (Ioan. 1; 29, 36) eadë se erdi permby dëst, qe te çperblenë çpirtet' e te-tijvet, te-cilote i dëç me qe dëçuri te per-jetëçmë, e te-cilote me ane t' ati u-pritne nde hir e nde paqtim perane Perendise, qe dyke pritire si bij t' ati te muntqene te benëne traçegimtare te Mbrëteris' se Perendise baëke me Kristine.

Keto vivla na pefejne, se qe te muntme tã çemojme e tã prësime kete bëkim, te Perendise, na beri

pjesetare te Frymes' se tij te-Cențeruare, qe sjeł nde zemerat t'ona bësene mbe lisu-Kriştine; eđe se, nde mos na perserilintte kejo Frym'e Përendise, dyke qertuare nëve per faj e dyke bindure nëve te sulëmi te lisu-Krişti, qe te mapeme ndjësën' e fajevët t'ane eđe drëjterine, bësë jone, nde munt tã quaqe qeriu keştu ešt' e-vdekure.

Keto vivła na vertetojne eđe, se giđ ajo Fryme na ep martiri, deçmim, e na verteton, se jami bij te Përendise, na ben te kemi mbe Përendine e mbe qerezite ate dæguri, per te-cilene flët Cenț-Pavli nde kryet 13 te Kartes' se-pare mbe Korindianet, eđe ben te lindete nder nê qe qperes' e-patundure, se dote fitojme jeten' e-perjetegmë; permby keke eton, se mē ane te kesaj, bësë qe vëperonete mē ane te dægurise e qe tregonete mē ane te pëmevët te-saj, daleme te-drëjte e qenqeronemi, do-më-đene Përendia e Ati i Zotit t'ene lisu-Krišt na eikon, na numeron e na perdor sikurse te içime farë te-drëjte, eđe nde giđ ate kohe ve nde zemerat t'onq qenqterine mē ane te qe vëperimi te hirit te-ti.

Mbe nde funt eikojme mē ane te fjales' se Përendise, do-më-đene mē ane te kartes' se-Cențeruare, se lisu-Krişti eđi nde botet, qe mē ane t'ati dyke qeruarë prej fajevët t'ane te muntme te mbuqme dægurimin' e ati mē te punuare punera te-mira, e t'i qerbejme prej zemerë mē drëjteri e mē qenqteri tere dilt' e jetese s'one; se lisu-Krişti dyke ðene per nê te Përendia gakh' e veteħes'.se-ti ndene çfarje Mestari nde mēst te Përendise e te qeresvët ešte eđe kryeqrifti yne, qe lutele per nê, qe te mapeme çdo qe kerkojme nga Përendia mē bësë mb' emerit t'ati.

Karterat' e-Cențeruara na vertetojne eđe, se giđ ay lisu-Krišt ka per te arđur' eđe qe here, nde qe kohe

që ka ndarë Përendia, që të pykëqë gjië qezëzite e që
 t' i ape sicilit si pas puneravet të-ti; atyqëqë që më ane
 të qe për më të hirit t' ati dote kerkojne pojtjen' e qe-
 timn' e tyre për ane ati eëë dote për sene të-arëurit' e
 ati më bese, më qprëse, e më gezim dot' u dote keto
 fjale të-gezuqëime: „Ejani, o të-bëkuaret' e t' im eti,
 tragëqoni mbrëterine që eëte bërë gati për ju që kur së
 eëte ngrehurë bota“; tëk atyqëqë që nukë dote zene
 për qe fjalën' e ti e dote hëdëqene tëj hirin' e ti dot' u
 dote: „Ikeni për mëjës, të-malëkuare, e eceni ndë zjart
 të-përjetëm, që eëte bërë gati për djalëin' e për enqejt' e-ti“.

Kart' e-Qëntëruare na u-ëa më ane të qe për më të
 hirit të-Përendisë e më ane të vëqerimit të Frymës' së
 Qëntëruare, që më ndihmen' e gjië asaj Frymë së-Qëntë-
 ruare të muntme të kupetojme e të bësojme së ka
 qe të-vetëme e të-vertëte Përendi, eëë qe të-vetëme
 Qëtimtar, që eëte lissu-Kriëti, të-cilëne Përendia e der-
 goj si pas të-zotuaravet të ti, që gjië ata që dote bësojme
 mb' atë të tragëqojne jëten' e-pasosurë; eëë Qënt Pavi
 dote, së eëti i-malëkuare ay që dote pëfëqë qe tjetërë
 bësë a qe tjetërë uëë qëtimmi për vëq asaj që eëte mbe
 lissu-Kriëtine; sëpës e Ati, si e Atit eëë e Frymës' së-
 Qëntëruare, eëte tërë ndërë e tërë lavdia, ndë jëtet
 të jëtevet.

Lëtë hapëme për Kartën' e-Qëntëruare më qe ndër
 të-maë eëë lëtë këdojme dykë luturë Zotit, që për da-
 çurin' e Birit të-ti të-dagurë të na ape Frymën' e-Qëntë-
 ruare, që të muntme t' i kupetojme këjëqëte gjië sa
 janë qëruarë nd' atë. Lëtë këdojme më kujdës, të të
 pojmë më zemërë të-këjëqëte pas porosivet t' asaj, eëë
 dykë lënë mbe q' ane çdo qprëse të-kotë mbe diturit
 e mbe qyqit t' enë të kerkojme nd' atë uëën' e jëtes' së-
 përjëtësme. Ndë ketë vivë të Përendisë dote qëjme

dritate, gezimn' e ngushimne per nje kete jete, eadhe qe
siguri lumerie te-patundure per oren' e vdekjese, eadhe
vlesin' a kaparin' e qe lumerie she-perjeteleme perane
Perendise me ane te Iisu-Kristit.

LEXIME TË MËTEJSHME:

- *Lëvizja Protestante Ndër Shqiptarët 1816-1908*, David Hosaflook, disertacion, Universiteti i Tiranës, 2007.
- *Rrugë Biblike në Shqipërinë e Vjetër*, Aleksandër Tomson, AEM-Misioni Ungjillor.
- *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*, Xhon Kuanrud, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2016.
- *Jeta Ime, Sevasti Qiriazi-Dako*, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2016.
- *Charles Telford Erickson: Jeta Dhe Vepra*, Mal Berisha, EDUALBA, 2012.


SHËNIME

1. H. Charles Woods, *Letër për Ritson*, 17.05.1913, BFBS.
2. Skëndo, Lumo, *Albania and the Bible Society, në The Bible in the World* (korrik, 1912) Londër: BFBS, f. 218–220.
3. Daniele Farlati, *Illyricum Sacrum, Vëllimi VII, Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis, et Sirmiensis cum earum suffraganeis*, 1817, fq. 339-341.
4. Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë ç'është e ç'do të bëhetë*, Bukuresht, 1899. (ribotim: Tiranë, 1962, fq. 54.)
5. Mihal Grameno, *Kryengritja Shqiptare*, 1925, fq. 58.
6. Shih: Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë ç'është e ç'do të bëhetë*, Bukuresht, 1899. (ribotim: Tiranë, 1962, fq. 56), *The Albanians: A Modern History*, Miranda Vickers, I.B.TAURIS, London, New York, fq.45-46, Edith Durham, *Albania and the Albanians*, Centre for Albanian Studies, London, 2001, fq. 71, dhe Sevasti Qiriazi-Dako, *Jeta ime*, ISShP, 2016, fq. 112-114.
7. *The Albanians: A Modern History*, M. Vickers, I.B.TAURIS, London, New York, fq. 59.
8. Xhon Kuanrud, *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*, ISShP, 2016, fq. 67.
9. Po aty, fq. 67-68.
10. *The 13th Annual Report of BFBS*, fq. 93-94 & raporti i 16-të, fq. 22-23. Përkthyer nga prof. dr. Xhevat Lloshi në librin *Përkthimi i V. Meksit & redaktimi i G.Gjirokastritit: 1819-1827* (Tiranë: Onufri, 2012), fq. 161-162.
11. Edwin Jacques, *Shqiptarët, KARTË E PENDË*, fq. 319.
12. *The 16th Annual Report of the BFBS*, fq. 23
13. Robert Elsie, *Albanian Literature in Greek Script*, të botuar në: *Byzantine and Modern Greek Studies*, Birmingham, 1991, fq. 20-34.
14. Dr. Xhevat Lloshi, *Rreth Alfabetit të Shqipes*, Logos-A, Shkup, 2008, fq. 112-113.
15. Dr. Xhevat Lloshi, *Përkthimi i V. Meksit & redaktimi i G.Gjirokastritit: 1819-1827*, Tirana, Onufri, 2012, fq. 81-83.
16. Po aty, fq. 89.
17. Lloshi, Xh., *Enigmat dhe befasishtë e Kristoforidhit në Maltë*, telegraf.al, 26 shkurt 2016.
18. *Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908*, David Hosaflook, disertacion, Universiteti i Tiranës, fq. 120-122.
19. Xh.Lloshi në hyrje të librit të K.Kristoforidhit, *Bibla: (në gegërisht) Kriesa. Të Dalëtë*, 1872, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e

- Shqipërisë, fq. 9-10.
20. *Annual Report of the BFBS*, Volume 67, Parts 1871-1872, fq. 203-204 & Vol 69, Parts 1873-1874, fq. 135, 215-216.
 21. *The 68th Report of the BFBS*, 1872, fq. 169-170, & William Canton, *A History of the British and Foreign Bible Society*, Vol. 3, London, 1910, fq. 227.
 22. Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania*, Scarecrow Press, 2010, fq. 249.
 23. Gjerasim Qiriazhi, *Pengu i kaçakëve*, ISShP, 2016, fq. 10.
 24. William Canton, *A history of the BFBS*, Vol. 4, London, 1910, fq. 388.
 25. *The 59th Report of the BFBS*, fq. 116-117.
 26. Edwin Jacques & David Young, *The Battle for Albania*, AEM, 1998.
 27. The 61st Report of the BFBS, fq. 147-148, & *The 62nd Report of the BFBS*, fq. 137
 28. Po aty, fq. 135-136.
 29. Edith Durham, *Albania and the Albanians*, Centre for Albanian Studies, London, 2001, fq.188-189, përkthimi i autorit.
 30. Alexander Thompson, *Rrugë Biblike në Shqipërinë e Vjetër*, AEM.
 31. Për shembull, në Korçë, në vitin 1868, protosingjeli i tregoi Davidsonit që patriarku e kishte urdhëruar që të ndalonte rreptësisht çdo blerje (Rrugë Biblike, AEM, fq.40). Kurse Sevasti Qiriazhi regjistron sesi një nga librashitësit “u mallkua dhe u shkishërua nga peshkopi grek, ngaqë shiste Bibla në gjuhën shqipe.” Megjithatë, duhet përmendur që kishte edhe klerikë ortodoksë që i përqafuan këto përkthime dhe që sot, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë përqafon përkthimin e Kristoforidhit.
 32. Z. Klundt humbi dy fëmijë, për shkak të sëmundjeve. Shih David Young, *Shqipëria: Çmimi*, AEM, 2002, fq. 12.
 33. David Young, *Shqipëria: Çmimi*, AEM, 2002, fq. 19.
 34. Kundërfolje: A mund të sjellë mirësi në botë Dituria pa Ungjill?, në Hristomathi, Vëll. I, fq. 177-182, të cituar në Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908, David Hosaflook, disertacion, Universiteti i Tiranës, fq. 269.
 35. Xhon Kuanrud, *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*, ISShP, 2016, fq. 49.
 36. Po aty, fq. 71, 79-81.
 37. Skënder Luarasi, *Gjerasim Qiriazhi: Jeta dhe Vepra*, 1962, fq.27.
 38. Gjerasim Qiriazhi, *Pengu i kaçakëve*, ISShP, 2016, fq.21.
 39. Po aty fq. 23.
 40. Po aty. fq. 132.
 41. Po aty, fq. 125-126.

42. S. Qiriazhi-Dako, *Jeta ime*, ISShP, 2016, fq. 113-116. Shih edhe: R. Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, I.B.TAURIS, fq. 288, & E.Durham, *Albania and the Albanians*, Centre for Albanian Studies, London, 2001, fq.71.
43. Gjerashim Qiriazhi, *Kristomaci, Rilindja, Illirycum/Rilindja*, Zagreb, 1991, fq. 113.
44. S. Qiriazhi, *Jeta ime*, ISShP, 2016, fq. 101-102.
45. Xh. Kuanrud, *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*, ISShP, 2016, fq.146.
46. *Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908*, D. Hosaflook, disertacion, Universiteti i Tiranës, fq. 302.
47. S. Qiriazhi-Dako, *Jeta ime*, ISShP, 2016, fq. 264, 274-75.
48. Po aty, fq.278.
49. Xh. Kuanrud, *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*, ISShP, 2016, fq. 208.
50. S. Qiriazhi-Dako, *Jeta ime*, ISShP, 2016, fq. 285.
51. *Intervistë me V.Rulin (Dakon)*, ABC News Special *Nënat e kombit, historia e motrave Sevasti & Parashqevi Qiriazhi*, 27 mars. 2012. www.abcnews.al/speciale/speciale/1/146 & V. Ruli (Dako), *Familjet Qiriazhi dhe Dako gjatë ditëve të regjimit komunist*, Illyria, 27 nëntor 1999. Shih edhe: S. Qiriazhi-Dako, *Jeta ime*, ISShP, 2016, fq. 283-288.
52. Anton Çefa, *Historia e familjes patriotike Qiriazhi*, ZemraShqiptare.net
53. Mihal Grameno, “*Kryengritja shqiptare*”, fq. 25-26.
54. E.Durham, *Albania & the Albanians*, London, 2001, fq.212
55. Richard M. Cochran, *Katerina Dimitrova Stephanova Tsilka*, ISShP, fq. 26-39.
56. Mihal Grameno, *Kryengritja shqiptare*, 1925, fq. 25-26.
57. Edwin Jacques, *Shqiptaret, KARTË E PENDE*, fq.293.
58. Mihal Grameno, *Kryengritja shqiptare*, 1925, fq. 54.
59. D. Young, *Lëvizja Protestante Midis Shqiptarëve 1908-1991*, TENDA, Prishtinë, fq. 72.
60. Richard M. Cochran, *Katerina Dimitrova Stephanova Tsilka*, ISShP, fq. 45.
61. Kristo Dako, *Albania: the master key to the Near East*, 1919, fq. 194-95.
62. Mihal Grameno, *Kryengritja shqiptare*, 1925, fq. 43-44.
63. *Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908*, D. Hosaflook, disertacion, Universiteti i Tiranës, fq. 271.
64. S. Skëndi, *The Albanian national awakening 1878-1912*, Princeton University Press, 1967, fq.135.
65. E. Durham, *Brenga e Ballkanit & vepra të tjera*, Shtëpia botuese

- “8 Nëntori”, fq. 49.
66. *Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908*, David Hosaflook, disertacion, Universiteti i Tiranës, fq. 271.
 67. D.Young, *Lëvizja Protestante Midis Shqiptarëve 1908-1991*, TENDA, Prishtinë, fq.70-72.
 68. Po Aty, fq. 39 (përkthim i autorit).
 69. Po Aty, fq. 127.
 70. C.T.Erickson, *Shqiptarët - Enigma e Ballkanit*, Pjesa e dytë, EDUALBA, 2012, fq.102-105.
 71. Po aty, fq. 136
 72. Po aty, fq. 115
 73. Po aty, fq. 117-118, 137-138, & *New York Times*, 15 nëntor, 1910.
 74. *The Missionary Herald*, Volume CIX, Feb 1913, Nr. 2. (Princeton Theological Seminary Library), fq.62-63.
 75. P.C.Braunlich, *Stone Pillows*, Xlibris, USA, fq.172 (përkthim i autorit).
 76. *The Missionary Herald*, Vol. CIX, Feb 1913, Nr. 2, fq. 62-63.
 77. C.T. Erickson, *Shqiptarët - Enigma e Ballkanit*, Pjesa e dytë, EDUALBA, 2012, fq.143-145.
 78. *The Missionary Herald*, Volume CIX, Feb 1913, Number 2. fq.76.
 79. *The Economist*, 17 maj 1913.
 80. P.C.Braunlich, *Stone Pillows*, Xlibris, USA, fq.188, & Erickson, *Shqiptarët - Enigma e Ballkanit*, Pjesa e dytë, EDUALBA fq.195.
 81. Po Aty, fq. 210-250.
 82. Intervistë me Mal Berishën, ISShP, <http://instituti.org/>
 83. Braunlich, *Stone Pillows*, Xlibris, USA, fq.245-246 & Erickson, *Shqiptarët - Enigma e Ballkanit*, Pjesa e dytë, fq.255-256, fq. 234-241.
 84. M. Berisha, *Biografi e Charles Telford Ericksonit*, EDUALBA, 2012, fq. 202, fq.218. Braunlich, *Stone Pillows*, Xlibris, USA fq. 221.
 85. C.T.Erickson, *Shqiptarët - Enigma e Ballkanit*, Pjesa e dytë, EDUALBA, 2012, fq.254.
 86. M. Berisha, *Biografi e Charles Telford Ericksonit*, EDUALBA, 2012, fq. 242-258.
 87. Po Aty, fq. 250.
 88. *The New York Times*, August 7, 1931.
 89. M. Berisha, *Biografi e Charles Telford Ericksonit*, EDUALBA, 2012, fq. 263 & Braunlich, *Stone Pillows*, Xlibris, fq. 267.
 90. *Guide to the Charles Telford Erickson Papers Record Group 26*, Yale University Library, <http://drs.library.yale.edu/>; & M.Berisha, *Biografi e Charles Telford Ericksonit*, EDUALBA, 2012, fq. 281-318.



HRISTOMATHI, 1907

TE VËRTETA
TE FIJME
PER CPETIMN'E CPIRTIT



MONASTIR
Ctypure ne ctypeck. "Baekim' i Kombit.,
1909.

TË VËRTETA TË FILLME PËR SHPËTIMIN E SHPIRTIT, 1909

